



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 17:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 9. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Sipas njoftimit të bërë, deklaroj të hapur mbledhjen e sotme datë 02.11.2023, me një rend dite i cili ju është bërë me dije.

Fillimisht do ju kërkoja nëse keni diskutime mbi përmbajtjen e rendit të ditës dhe kronologjinë e shqyrtimit të çështjeve?

Po, zoti Toro, fjala për ju!

Alban Toro: Faleminderit!

Unë do të kërkoja në fakt të shtyhej diskutimi në lidhje me pikën 4 (bëhet fjalë për pikën 5 të rendit të ditës) sepse për shkak edhe të ngarkesës së konsiderueshme që ka pasur Komisioni, nuk kam mundur ta studioj në mënyrë të thellë këtë pjesë. Për sa i kam

hedhur një sy projekt-udhëzimit, disa dispozita më kanë ardhur në kundërshtim me eksperiencën, të paktën të vendeve që na rrethojnë. Kështu që do doja të njihesha më tepër me materialet që kanë shërbyer për të krijuar udhëzimin nga ana e Komisionit të Posaçëm që ka punuar për të dhe do doja pak kohë ta konsultoja këtë material që disponojmë dhe që ka shërbyer si bazë për formatimin e këtij materiali. Kështu që, më vjen keq, por më duhet të kërkoj shtyrjen e diskutimit në lidhje me pikën 4.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime të tjera, sipas praktikës së krijuar nga ky Këshill, kur një anëtar kërkon kohë për t'u njohur me materialet, atëherë kjo çështje që është bërë pjesë e rendit të ditës shtyhet për t'u diskutuar në një mbledhje të ardhshme. Kështu që, pika e rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median" për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, do të shtyhet për t'u diskutuar në një mbledhje të ardhshme.

Meqenëse nuk ka diskutime të tjera, do vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve", për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Klodian Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar kolegë!

Në mënyrë të shkurtuar unë po paraqes relacionin në mënyrë të përmbledhur në lidhje me kërkesën dhe shkresën që ka paraqitur edhe një herë Shkolla e Magjistraturës për të hapur sërish procedurën e komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve. Është një kërkesë e ripërsëritur dhe kjo është hera e tretë që brenda këtij viti Shkolla e Magjistraturës paraqet të njëjtën kërkesë.

Janë të njëjtat kritere të kërkuara nga Shkolla e Magjistraturës, dhe kërkon që nëpërmjet procedurës së komandimit të caktohet një gjyqtar për të qenë pedagog në Shkollën e Magjistraturës për një afat kohor prej 2 vjetësh.

Kërkesa e paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës është depozituar në KLGJ më datë 20.10.2023. Kemi bërë verifikimet paraprake. Nuk ka kritere të reja përtej atyre që ajo i ka parashtruar si në kërkesën e parë ashtu edhe në kërkesën e dytë. Duke vlerësuar Shkolla e Magjistraturës situatën emergjente të saj në mungesë të stafit pedagogjik, ka kërkuar, duke shfrytëzuar edhe dispozitat e ligjit “Për statusin” (nenet 54 - 58), shfrytëzon këtë hapësirë për të marrë/rekrutuar një gjyqtar, me qëllim që ai të vijojë më tej nëpërmjet procedurës së komandimit funksionet e pedagogut në Shkollën e Magjistraturës.

Kështu që, duke vlerësuar rrethanat të cilat nuk kanë ndryshuar dhe qasjes së Komisionit në situata të tjera të ngjashme brenda këtij viti, ne si Komision paraqesim relacionin dhe bashkë me të projektvendimin për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura.

Së bashku me relacionin është edhe projektvendimi. Është i njëjti pothuajse model me ato çfarë kemi bërë edhe në dy rastet e mëparshme që kemi bërë këtë vit. Kështu që, nëse ju dëshironi që të zgjatem për të lexuar edhe projektvendimin, së bashku me krerët e saj, unë jam gati t’i lexoj por këto janë bashkëlidhur dhe besoj se tashmë kolegët janë njohur me materialin përkatës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Nuk ka diskutime.

Në lidhje me afatin zoti Kurushi?

Klodian Kurushi: Për afatin unë propozoj, meqenëse e kemi lënë në traditën tonë për ta diskutuar në Këshill, unë propozoj 2 javëshin siç e kemi propozuar edhe në raste të tjera të ngjashme, siç e përmenda. Unë propozoj datën 17 që është ditë e premte, si afat të fundit të dorëzimit të kërkesave të kandidatëve. 17 nëntor 2023.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime, po vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës.
2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm.

3. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është deri më 17.11.2023.

4. Bashkë me kërkesën për komandim, kandidati duhet të dorëzojë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor edhe dokumentet që provojnë plotësimin e kriterëve të komandimit.

I. Kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit

1. Kohëzgjatja e komandimit, në pozicionin e shpallur, është 2 (dy) vjet, me të drejtë ripërsëritje.

2. Kohëzgjatja e komandimit, në pozicionin e shpallur mund të përfundojë para afatit:

- a) me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;

- b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit.

c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore;

ç) kur gjyqtari i komanduar jep dorëheqjen;

d) kur gjyqtari i komanduar largohet nga detyra.

3. Kushtet e komandimit, në pozicionin e shpallur, janë:

a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;

b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;

c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar;

ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë: i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit; nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës;

d) Kandidati nuk duhet të ketë masë disiplinore në fuqi.

4. Kriteret e komandimit për pozicionin “Pedagog i brendshëm”, janë:

a) Kandidati duhet të ketë eksperiencë pune mbi pesëmbëdhjetë vjet si jurist, gjyqtar, prokuror, avokat dhe eksperiencë mësimdhënie si pedagog i brendshëm në sistemin universitar ose pedagog i jashtëm ose i brendshëm në Shkollën e Magjistraturës, mbi dhjetë vjet; ose

b) Kandidati, që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, duhet të ketë eksperiencë mbi dhjetë vjet si gjyqtar dhe eksperiencë mësimdhënie universitare në lëndët kryesore ose në Shkollën e Magjistraturës mbi pesë vjet.

5. Kriteret specifike të komandimit janë:

a. Të ketë kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar nga organet e Vettingut.

6. Për vlerësimin e kushteve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

7. Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se

një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera ose kriteret e komandimit, me përjashtim të atij të mësimdhënies.

8. Emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për komandim, me përjashtim të atij të mësimdhënies, së bashku me opinionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe dokumentacionin e paraqitur prej tyre, i përcillen menjëherë për vlerësim Shkollës së Magjistraturës.

9. Vlerësimi i kriterit të komandimit të mësimdhënies dhe i kriterëve shtesë për pozicionin vakant si më sipër, bëhet nga Shkolla e Magjistraturës, në zbatim të Rregullores së Brendshme të miratuar prej saj. Shkolla e Magjistraturës njofton kandidatin për depozitimin pranë saj të çdo dokumentacioni tjetër shtesë, me qëllim vlerësimin e plotësimit të kriterëve të tjera të parashikuara në Aneksin 11 të Rregullores së Shkollës.

10. Përzgjedhja e kandidatit për vendin vakant në pozicionin e pedagogut të brendshëm, bëhet me vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës.

11. Brenda dy javëve nga marrja e vendimit të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, si dhe të kërkesës për komandim nga Shkolla, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin e gjyqtarit të përzgjedhur, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Shkollën e Magjistraturës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 559, datë 01.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 17:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Irena Plaku* (anëtare)
4. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 559, datë 01.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relatore *znj. Marçela Shehu*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 2 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për shfuqizimin e vendimit nr. 559, datë 01.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni Disiplinor. Për më tej fjalën relatores *znj. Shehu*.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Sikurse e cituat, Komisioni Disiplinor i ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare projektvendimin “Për shfuqizimin e vendimit nr. 559, datë 01.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-

magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”, duke cituar si më poshtë:

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në datë 11.10.2021, është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit, z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr.115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja "d" e këtij ligji .

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit z. {...}, të masës disiplinore, "Ulje e përkohshme e pagës deri në 40% për një periudhë jo më të gjatë se një vit", të parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja "c", ndarja "i" dhe neni 108 i Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ", të ndryshuar.

Pas depozitimit të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me vendimin nr. 472, datë 13.10.2021, është caktuar dhe relatori i çështjes, dhe me vendimin nr. 490, datë 19.10.2021, ka vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore, duke caktuar datën e zhvillimit të saj në 10.11.2021.

Ndërkohë, magjistrati z. {...}, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit ex officio, duke u shortuar si subjekt me shortin e datës 25.11.2021. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 478, datë 25.11.2021, ka vendosur:

1. Shkarkimin nga detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.

Subjekti i procedimit disiplinor z. {...}, ka ushtruar të drejtën e ankimit para Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndaj vendimit të ndërmjetëm nr. 478, datë 25.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Pas njohjes me këto rrethana faktike dhe ligjore, në seancën dëgjimore të datës

01.12.2021, relatori i çështjes i parashtrori Këshillit të Lartë Gjyqësor, propozimin e tij për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...}, deri në marrjen formë të prerë të vendimit të dhënë nga organi kompetent i rivlerësimit.

Në referim të këtyre fakteve dhe të kësaj situate juridike, Këshilli i Lartë Gjyqësor në referim të neneve 126, 145 të Ligjit Për Statusin, si dhe në lidhje me nenin 66 të K.Pr.Administrative, ka konsideruar se jemi në kushtet e pezullimit të procedimit disiplinor të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë deri në përfundim të çështjes së rivlerësimit, duke vlerësuar se mbajtja ose jo e statusit të magjistratit nga ai, përbën parakusht për shqyrtimin në themel të procedimit disiplinor ndaj tij.

Në këto kushte, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 559, datë 01.12.2021 ka vendosur:

Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 478, datë 25.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Në vijim, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka njoftuar Këshillin e Lartë Gjyqësor për shqyrtimin e ankimit ndaj Vendimit nr. 478, datë 25.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përfundim të të cilit me vendimin nr. 14, datë 07.04.2023 ka vendosur: “1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 478, datë 25.11.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, z. {...}. 2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm”.

Në kushtet kur tashmë shkak i pezullimit të procedimit disiplinor, konsideruar nga Këshilli, në vendimin e tij nr. 559, datë 01.12.2021 për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 478, datë 25.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, ka rënë dhe nuk ekziston më, nga Komisioni Disiplinor vlerësohet se duhet të shfuqizohet vendimi i pezullimit dhe çështja të vijojë të trajtohet nga Mbledhja Plenare e cila do të duhet tashmë të zgjidhë në themel çështjen.

Sa sipër, Komisioni Disiplinor në mbledhjen e datës 02.10.2023 vendosi t'i parashtrojë Mbledhjes Plenare projekt vendimin për Shfuqizimin e vendimit nr. 559 datë 01.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar

ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 478, datë 25.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

Projektvendimi është i strukturuar si më poshtë:

Në pikën e parë të projektvendimit propozohet Shfuqizimi i vendimit nr. 559 datë 01.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pikën dy të projektvendimit është parashikuar propozimi për vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në ish-Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe caktimin e seancës vijuese dëgjimore për njoftimin e palëve.

Në pikën e tretë është përcaktuar njoftimi i vendimit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky është dhe propozimi që Komisioni Disiplinor i paraqet sot mbledhjes plenare. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime?

Besoj se diçka në lidhje me datën.

Marçela Shehu: Po!

Atëherë, në lidhje me pikën 2 të projektvendimit propozohet që data e seancës së ardhshme dëgjimore të jetë data 21 nëntor, ora 11:00.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime, duke marrë në konsideratë edhe këtë propozim të fundit të zonjës Shehu?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për shfuqizimin e vendimit nr. 559, datë 01.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish-magjistratit {...} dhe vijimin e shqyrtimit të tij”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 559 datë 01.12.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 478, datë 25.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

2. Vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në ish Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe caktimin e seancës dëgjimore me datë 21.11.2023, ora 11:00.

Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjektit.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin dhe përlogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar), për periudhën 1 janar 2019 deri më 08 janar 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 17:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Irena Plaku* (anëtare)
4. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin dhe përllogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar), për periudhën 1 janar 2019 deri më 08 janar 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, (relatore *znj. Marçela Shehu*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për caktimin dhe përllogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar), për periudhën 1 janar 2019 deri më 08 janar 2023”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxheti. Për më tej fjalën relatores *znj. Shehu*.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Atëherë, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i paraqet sot për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimin “Për përllogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjyqtar), për periudhën 1 janar 2019 deri më 08 janar

2023”.

Sikurse jeni në dijëni, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, pas kërkesës së paraqitur nga Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, me objekt: “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 2 pika 1 të ligjit nr.50./2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.96/2016 “Për statusin”, ka vendosur pranimin e kërkesës duke shfuqizuar, ndër të tjera, nenin 12, pika 5, shkronja “a” të ligjit “Për statusin”, të ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Në dispozitivin e vendimit, Gjykata Kushtetuese është shprehur se ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 3/2023 dhe ka hyrë në fuqi me datën 9 janar 2023.

Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 35, datë 22.11.2022, e ka vlerësuar çështjen nën dritën e parimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor, ka analizuar qartësisht përlllogaritjen e pagës referuese të magjistratit, përpara dhe pas hyrjes në fuqi të ndryshimit ligjor, që u shfuqizua, si dhe për efektet e vendimit të saj.

Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese është shprehur se neni 12, pika 5, shkronja "a", i ligjit nr. 96/2016 në formulimin fillestar referon në kategorinë e parë, në nivelin/klasën më të ulët të kësaj kategorie dhe njësohej me pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose pozicionet e tjera të barasvlershme me të, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe sekretarët e përgjithshëm në njësitë e qeverisjes vendore, paga e të cilëve është klasifikuar në kategorinë I-b, sipas terminologjisë së VKM-së së pagave në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016. Elementi "pagë referuese bazë" i pagës mujore bruto të magjistratit i referohet pagës për pozicion të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë, në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të, që përfshin "shtesën për pozicion" dhe "pagën në grup" sipas grupit të diplomave universitare për këto funksione. Edhe pse dispozita ligjore nuk mbarte paqartësi në lidhje me konceptet ku referonte, zbatimi i saj jo në linjë më frymën dhe qëllimin e ligjvënësit ka prodhuar një rezultat të ndryshëm nga ai që ka diktuar vetë norma ligjore, neni 12, pika 5, shkronja "a", e ligjit nr. 96/2016 (paragrafi 78 i vendimit të Gjykatës Kushtetuese).

Duke krahasuar formulimet e normës ligjore para dhe pas ndryshimeve të saj, ato

mbartin diferenca të dukshme në referencat e bëra në drejtim të përcaktimit të elementit të pagës bruto mujore të magjistratit, pikërisht të "pagës referuese bazë" (paragrafi 80 i vendimit). Pavarësisht mënyrës së zbatimit të normës, në kushtet kur ajo diktonte një mënyrë tjetër llogaritjeje të pagës referuese bazë të magjistratit, ndryshimi që i është bërë me ligjin nr. 50/2021, ka sjellë një rezultat, në terma financiare, më të ulët sesa ai që magjistratët do të përfitonin nga zbatimi korrekt i normës origjinale, sipas përmbajtjes së tekstit të saj dhe vullnetit objektiv të treguar nga ligjvënësi në kohën e miratimit të kësaj norme për herë të parë. Për rrjedhojë, formulimi aktual i normës ligjore objekt i gjykimit kushtetues, edhe pse synimi i pretenduar ishte qartësimi i përmbajtjes së saj, në fakt ka sjellë ndryshim të dukshëm të kësaj përmbajtjeje, me pasojë uljen në vlerë të "pagës referuese bazë" e në këtë kuptim uljen e pagës bruto mujore të magjistratit (paragrafi 82 i vendimit). Gjykata ka arritur në përfundimin se ligjvënësi ka vepruar në kushtet e ndalimit të parashikuar në nenin 138 të Kushtetutës, ndaj përmbajtja e shkronjës "a" të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 96/2016, duhet të shfuqizohet si e papajtueshme me këtë normë kushtetuese (paragrafi 85 i vendimit).

Në lidhje me efektet e vendimit, Gjykata Kushtetuese, duke theksuar rëndësinë e garancive dhe të parimeve kushtetuese me të cilat bien ndesh dispozitat e kundërshtuara, si dhe duke vënë në balancë interesat e mbrojtura, ka vlerësuar në përputhje me pikën 2 të nenit 132 të Kushtetutës dhe nenin 76, pikat 1, 2 dhe 3, të ligjit nr. 8577/2000, vendimi duhet të hynte në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Gjykata ka vlerësuar të theksojë se ligjvënësi, brenda hapësirës së tij normuese, në formulimin e normës së re ligjore për pagën e magjistratit ka diskrecionin t'i referohet formulës aktuale të referencës në shërbimin civil ose çdo formule tjetër që referon në legjislacionin në fuqi për pagat e funksionarëve publikë, duke qenë kjo një çështje që i përket oportunitetit të saj. Megjithatë, në ushtrim të kompetencave të tij, në plotësimin e kuadrit ligjor ai duhet të mbajë parasysh përcaktimet e nenit 138 të Kushtetutës, duke garantuar, në çdo rast, që paga dhe përfitimet e tjera që vijnë si rrjedhojë e zbatimit të sistemit të referencës së pagave, të mos ulen nën standardin e analizuar në këtë vendim, përveç kur verifikohet përjashtimi i nenit 138, shkronja "a", të Kushtetutës (paragrafi 103 i vendimit).

Në lidhje me efektin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, vlerësohet roli kushtetues i saj. Në këtë drejtim, neni 124, paragrafi i parë i Kushtetutës, përcakton se: "Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës", ndërsa neni 131, paragrafi i parë, shkronja "a", i jep kompetencën asaj për të vendosur për pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën. Më tej, neni 132, paragrafi i parë, i Kushtetutës parashikon se: "Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim". Në të njëjtën linjë, lidhur me efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, neni 76, paragrafi i parë i ligjit nr. 8577/2000, përcakton se: "Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim".

Sipas nenit 132, pika 1, të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare dhe, si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit.

Në logjikën e këtij vlerësimi që ka bërë Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 211, datë 18.01.2023, i ka kërkuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e organit përgjegjës dhe më të specializuar për menaxhimin e buxhetit të shtetit, të vlerësojë se sa do të jetë paga referuese bazë e magjistratit (gjyqtar), nga data 9 janar 2023 e në vazhdim, me qëllim përllogaritjen e efektit financiar (sipas këtij vendimi), për buxhetin e sistemit gjyqësor.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 2195, datë 02.02.2023, u është drejtuar të gjitha institucioneve që preken nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, përfshirë këtë të fundit, po edhe KLGJ-në, duke vlerësuar se për sa kohë që vendimi nr. 35, datë 22.11.2022 ka shfuqizuar shkronjën "a" të pikës 5 të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016, ai nuk prodhon më efekte juridike, duke lënë të parregulluar nga ana ligjore, deri në miratimin e normës së re nga Kuvendi, një prej elementeve të pagës bruto të magjistratit. Po sipas shkrese, përllogaritja e pagave, deri në normimin e ri, duhet të kryhet në të njëjtën mënyrë siç bëhej para vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në drejtim të standardit të paprekshmërisë së pagës, sipas nenit 138 të Kushtetutës.

Në kushtet kur nuk ka një normë ligjore që përcakton pagën referuese të magjistratit pamundësohet përllogaritja e pagave të tyre. Për këtë shkak në drejtim të standardit kushtetues për paprekshmërinë e pagës së magjistratit, deri në miratimin e një dispozite që përcakton pagën referuese nga Kuvendi, përllogaritja e pagave do të duhet të kryhet në të njëjtën mënyrë si edhe më përpara vendimit të Gjykatës Kushtetuese, duke garantuar në këtë mënyrë respektimin e nenit 138 të Kushtetutës.

Me miratimin e normës së re ligjore nga Kuvendi, me ligjin nr. 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016, të ndryshuar, paga referuese bazë për magjistratin (gjyqtar) është vendosur në masën 0.36% të pagës së Presidentit të Republikës, si dhe në vlerë absolute në shumën 153,000 lekë, si dhe sipas këtij ligji efektet financiare fillojnë nga 1 prill 2023 e në vazhdim.

Me vendimin nr. 351, datë 27.07.2022 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në disa vendime të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një ekonomi gjyqësore dhe me qëllim përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, ka vendosur miratimin e rekomandimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, se për të gjithë magjistratët dhe këshilltarët ligjorë jomagjistratë në Gjykatën e Lartë, pavarësisht nga pozicioni i tyre i punës, paga referuese bazë të përllogaritet mbi bazën e plotë të pagës së Drejtorit të Drejtorisë së Përgjithshme në Kryeministri, e cila përbëhet nga paga e grupit, plus shtesën e pagës dhe jo siç përllogaritet aktualisht, vetëm mbi shtesën për pozicion. Pagesa duhet të bëhet duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin” dhe të përllogaritet për të gjithë periudhën, bashkë me të gjitha shtesat dhe pakësimet, sipas rastit, për periudhën 1 janar 2019 deri më 28 maj 2021, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr. 50/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016”.

Me hyrjen në fuqi të vendimit nr. 35, datë 22.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese, jemi në një situatë tjetër ligjore dhe buxhetore.

Pasi sipas arsytimit të Gjykatës Kushtetuese, ajo i referohet kategorizimit të pozicioneve të shërbimit civil sipas ligjit nr.152/2013, neni 19, sipas kategorive, klasave dhe natyrës së pozicionit.

Në arsyetimin e saj në vendimin nr. 35, Gjykata Kushtetuese, në kreun B.1.1. “Për cenimin e pagës së magjistratit”, analizon disa akte ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me elementët e pagës së magjistratit dhe nëpunësit civil.

Në kohën kur u miratua ligji nr. 96/2016, VKM-ja e pagave nr.545/2011, në lidhjen nr. 1, rregullonte strukturën dhe nivelin e pagave edhe për nëpunësit civilë në institucionin e Kryeministrit. Struktura e pagave për nëpunësit civilë në institucionet, pjesë e fushës së veprimit të kësaj VKM-je, bazohet mbi klasifikimin në klasa, që më tej ndaheshin në kategori,

Elementi “shtesë për pozicion” përcaktohet me vlerë fikse për secilën klasë dhe kategori. Klasa e parë ndahet në dy kategori dhe më konkretisht, shtesa për pozicion për kategorinë e parë I-a përcaktohet në vlerën 129,000 lekë, ndërsa për kategorinë e dytë I-b në vlerën 118,000 lekë.

Në referim të legjislacionit të kohës për nëpunësin civil, gjykata vlerëson se neni 12 i ligjit nr. 96/2016 ka përcaktuar qartë dhe mjaftueshëm elementet e pagës mujore bruto të magjistratit dhe në veçanti elementin “pagë referuese bazë”. Konkretisht, kjo dispozitë ka përcaktuar se paga referuese bazë është e njëjtë me pagën për funksion të nëpunësve civilë të nivelit më të lartë drejtues, të shprehur në konceptin e kategorisë së parë, klasa e tretë, ku sipas ligjit për nëpunësin civil përfshihet pozicioni i punës “drejtor i drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose çdo pozicion i barasvlershëm me të”. Fakti se VKM-ja e pagave nuk përmbante klasë të tretë të kategorisë së parë, nuk përbën argument për paqartësi ose boshllëk të nenit 12, pika 5, shkronja “a”, e ligjit nr. 96/2016 në formulimin fillestar. Kjo dispozitë referon në kategorinë e parë, në nivelin/klasën më të ulët të kësaj kategorie dhe njësohet me pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose pozicionet e tjera të barasvlershme me të, ku përfshihen, ndër të tjera, edhe sekretarët e përgjithshëm në njësitë e qeverisjes vendore, paga e të cilëve është klasifikuar në kategorinë I-b, për të cilën elementi i shtesës për pozicion, sipas terminologjisë së VKM-së së pagave në kohën e miratimit të ligjit nr. 96/2016, ishte në vlerën 118,000 lekë.

Në kuptim të nenit 12 të ligjit nr. 96/2016, gjykata vëren se, elementi “pagë referuese bazë” i pagës mujore bruto të magjistratit sipas shkronjës “a” të pikës 5 të këtij

neni, i referohet pagës për pozicion të punonjësve të shërbimit civil të kategorisë së parë, klasa e tretë, në pozicionin e drejtorit të drejtorisë së përgjithshme në Kryeministri ose çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me të, që përfshin “shtesën për pozicion” dhe “pagën në grup” sipas grupit 1 të diplomave universitare për këto funksione, e cila sipas VKM-së nr. 545/2011 për pagat, i shfuqizuar, VKM-në nr. 817/2017 për pagat, i ndryshuar, dhe VKM-në nr. 621/2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 187, datë 08.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar, konsiston në klasën e parë, kategoria e dytë (niveli I-b).

Në logjikën e këtij vlerësimi dhe arsytimi, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Udhëzimin nr.17, datë 16.02.2023 “Për llogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit” ka udhëzuar përllogaritjen e pagës referuese bazë për të gjithë magjistratët (gjyqtarë), si shumatore të shtesës për pozicion plus pagën e grupit.

Bazuar në të njëjtin arsyetim dhe të njëjtën logjikë, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancës plenare, shqyrtimin dhe miratimin e projektvendimit “Për përllogaritjen e “Pagës referuese bazë” të magjistratit, të barabartë me shumën e shtesës për pozicion të nëpunësit të shërbimit civil Klasa e parë (I), Kategoria e dytë (I-b), niveli I-b plus pagën e grupit, për periudhën nga data 1 janar 2019 deri më datë 8 janar 2023. Bashkangjitur është edhe projektvendimi përkatës.

Miratimi i këtij projektvendimi dhe përllogaritja siç duhet e pagës referuese bazë të magjistratit është të vendosë të gjithë magjistratët edhe në barazi me njeri-tjetrin. Sot ne kemi shumë vendime gjyqësore me palë të paditur Këshillin e Lartë Gjyqësor, që kanë rregulluar pikërisht këtë moment. Unë do të referoja numrin e padive: Aktualisht janë në proces 109 padi. Janë pranuar 30. Nuk është rrëzuar asnjë padi.

Ky është edhe qëndrimi i Komisionit. Pastaj nëse ka dikush tjetër për të shtuar, qoftë me arsytimin, qoftë me projektvendimin... Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Unë dakordësohem plotësisht me qëndrimin e Komisionit, por doja të shtoja diçka, dhe një arsye ndoshta më tepër pse e mbaj këtë qëndrim.

Ka pasur një diskutim lidhur me efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, e cila ka shfuqizuar dispozitën përkatëse të argumentuar nga relatorja. Për arsye sepse Gjykata Kushtetuese shfuqizoi ndryshimin e ligjit “Për statusin” në pjesën e ligjit të vitit 2021, për pjesën e mënyrës së përcaktimit të pagës për funksion, pagës bazë të gjyqtarit që e kishte barazuar me pagën për funksion, dhe efektet e vendimit të saj i dha pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Referuar ligjit “Për Gjykatën Kushtetuese”, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si rregull (dhe është neni 76 i ligjit) kanë efekte nga dita e botimit të tyre ose nga data e hyrjes në fuqi që është data e botimit të tyre. Përrjashtimisht në nenin 76 të ligjit “Për Gjykatën Kushtetuese” janë përcaktuar edhe rastet kur vendimi ka efekt prapaveprues dhe një nga këto raste se kur vendimi ka efekt prapaveprues është pikërisht pika ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykata derisa vendimet e tyre nuk janë përfunduar dhe të jenë të formës së prerë. Nga momenti kur u shpall vendimi i Gjykatës Kushtetuese deri në momentin kur hyri në fuqi, ka kaluar një kohë sepse ka hyrë në fuqi në janar. Gjatë kësaj periudhe janë paraqitur shumë padi nga ana e gjyqtarëve pikërisht për të kapur këto efekte prapavepruese që do të krijonte vendimi i Gjykatës Kushtetuese.

Çfarë kemi ne sot në sistem? Ne sot në sistem kemi një grup gjyqtarësh që për të njëjtën punë nuk kanë arritur dot të bëjnë padi dhe nuk po marrin pagën sipas barazisë kushtetuese dhe kemi një grup tjetër gjyqtarësh të cilët kanë bërë të njëjtën punë por vetëm sepse kanë bërë padi para se vendimi i Gjykatës Kushtetuese të hynte në fuqi dhe po marrin pagat sipas arsyetimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në kuadër të rolit që ka Këshilli, jo vetëm për miradministrimin e buxhetit dhe përdorimin me efikasitet të burimeve të veta financiare, me qëllim që të mos rriten kostot e shpenzimeve gjyqësore për ekspertë, për interesa, të cilat prodhohen nga këto mosmarrëveshje juridiko-civile, përveçse ka edhe detyrimin që të garantojë barazi në

trajtimin e gjyqtarëve për shkak të statusit të tyre. Paga e gjyqtarit është element i rëndësishëm i statusit të gjyqtarit. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese duhet të lexohet në frymën që përcakton se cilat janë elementët përkatës të pagës së gjyqtarit. Në kushtet kur Kushtetuta parashikon që të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe paga e gjyqtarit nuk mund të ulet, as përfitimet e tjera, edhe unë ndaj të njëjtin qëndrim dhe i bashkohem edhe relacionit të paraqitur nga ana e Komisionit se për të gjithë periudhën nga momenti i hyrjes së ligjit në fuqi deri në momentin kur Parlamenti reflektoi dhe bën një parashikim ligjor pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarët duhet të paguhen me anë të të njëjtës metodologji page dhe duhet të paguhen sipas asaj çka arsyeton Gjykata Kushtetuese, për mënyrën se si përcaktohet paga në funksion, paga bazë e magjistratit që është paga në funksion dhe që ne e kemi të detajuar tashmë në këtë projektvendim që i paraqitet sot për miratim mbledhjes plenare. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime?

Nisur nga sa u parashtrua, titulli i projekt-aktit do jetë “Për përlllogaritjen e pagës...” dhe tek pika 1, terminologjia “caktim” do të hiqet dhe do jetë “Paga referuese bazë” e magjistratit është e barabartë...”. Këto do të jenë terminologjitë që do të përdoren për këtë akt.

Faleminderit!

Nëse nuk ka diskutime, atëherë hedhim në votim projektvendimin duke marrë në konsideratë diskutimet, parashtruesat dhe terminologjinë e re të përdorur për këtë akt.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për përlllogaritjen e pagës referuese bazë të magjistratit (gjqqtar), për periudhën 1 janar 2019 deri më 08 janar 2023”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. “Paga referuese bazë” e magjistratit (gjqqtar), është e barabartë me shumën e shtesës për pozicion të nëpunësit të shërbimit civil Klasa e parë (I), Kategoria e dytë (I-b), niveli I-b, plus pagën e grupit, për periudhën nga data 1 janar 2019 deri më 8 janar 2023.

2. Përlllogaritjen e “Pagës referuese bazë” të magjistratit (gjqqtar), sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij vendimi, duke përfshirë edhe efektet financiare që ka prodhuar vendimi nr. 351, datë 27.07.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Ngarkohet Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, me ndjekjen e procedurave ligjore e nënligjore për menaxhimin e sistemit buxhetor, duke marrë masat e duhura për përlllogaritjen dhe sigurimin e fondeve buxhetore të nevojshme për pagën referuese bazë, nga fondet e buxhetit të vitit në vazhdim dhe duke kërkuar fonde shtesë për vitin 2024 për gjithë sistemin gjyqësor.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit në Këshillin e Lartë Gjyqësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat””, i ndryshuar, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 17:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Irena Plaku* (anëtare)
4. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
5. *Ridvan Hado* (anëtar)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Marçela Shehu* (anëtare)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicantaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat””, i ndryshuar, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, (relatore *znj. Marçela Shehu*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar” për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatores *znj. Shehu*.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit i paraqet sot për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i

ndryshuar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 91, pika 3 e Ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me vendimin nr. 280, datë 10.12.2019, të ndryshuar me vendimet nr. 292, datë 06.07.2021; nr. 424, datë 29.09.2021; nr. 254, datë 07.07.2022; nr. 515, datë 21.11.2022 dhe nr. 101, datë 06.03.2023, ka vendosur caktimin e gjyqtarëve, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat në gjykatat e apeleve dhe në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Rezulton se, me vendimet nr. 320 dhe nr. 322, datë 14.06.2023, gjyqtarët {...} dhe {...}, janë komanduar në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë për një afat 5-vjeçar.

Sa sipër, gjyqtarët z. {...} dhe znj. {...}, të caktuar si Gjyqtarë për Median me vendimin nr. 101, datë 06.03.2023 të Këshillit, respektivisht pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan dhe Lezhë, nuk mund të ushtrojnë më këtë funksion pranë këtyre gjykatave.

Ndërkohë, me vendimin nr. 520, datë 05.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtari z. Gjergji Baçi i cili ushtronte detyrën e gjyqtarit për median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, është transferuar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 529, datë 11.10.2023 ka vendosur gjithashtu transferimin e përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një periudhë deri në një vit.

Sa sipër, gjyqtarët Gjergji Baçi dhe {...} (sikurse dhe dy gjyqtarët e tjerë që u cituan {...} dhe {...}), nuk mund të ushtrojnë më funksionin e gjyqtarit të mediave pranë gjykatave ku ata ishin caktuar.

Gjithashtu, rezulton se z. {...} i caktuar si Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, aktualisht, është zgjedhur si zëvendëskryetar i kësaj gjykate.

Në këto kushte, me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimit kushtetues për informimin e publikut në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, në zbatim të nenit 91 të Ligjit nr. 115/2016 “Për

organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe vendimit nr. 590, datë 26.11.2020 “Për miratimin e Planit Strategjik të Komunikimit për sistemin gjyqësor”, të Këshillit, ka përgatitur projektvendimin “Për ndryshimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e Gjyqtarëve për Mediat”, i ndryshuar”, duke konsideruar edhe mendimet e dhëna nga gjykatat respektive.

Gjithashtu, në këtë projektvendim, duke konsideruar specifikën dhe sensitivitetin e gjykimeve të gjykatave të posaçme, nga ana e Komisionit është vlerësuar dhe caktimi i një gjyqtari për mediat pranë Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Caktimi i një gjyqtari për mediat, specifikisht për këtë gjykatë, ka qenë dhe është dhe një kërkesë dhe shqetësim i kësaj gjykate.

Në pikën 1 të projektvendimit është përcaktuar ndryshimi i pikës 1 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019.

Në pikën 2 përcaktohet se ngarkohen Gjyqtarët për Mediat dhe gjykatat përkatëse të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ndërkohë unë do doja të citoja edhe gjyqtarët që propozohen nga ana e Komisionit, që caktohen në këto pozicione. Konkretisht:

Në Juridiksionin e Përgjithshëm të Apelit:

z. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

znj. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër;

znj. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

z. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë;

znj. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Ndërsa, nën Juridiksionin e Apelit për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar:

z. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë

kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Ky është edhe propozimi i Komisionit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime vazhdojmë me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”.

Këshilli i Lartë gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të ndryshuar, si më poshtë:

Caktimin e gjyqtarëve të mëposhtëm, në pozicionin e Gjyqtarit për Mediat

Në Juridiksionin e Përgjithshëm të Apelit:

z. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan;

znj. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë;

znj. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë;

z. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Lezhë;

znj. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër;

Në Juridiksionin e Apelit për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar:

z. {...} – Gjyqtar për Median pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

2. Ngarkohen Gjyqtarët e caktuar për Mediat dhe gjykatat përkatëse të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 17:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

¹ Sipas rendit kjo çështje renditet nr.6. Pika 5 e rendit shtyhet. Shih procesverbalin e pikës së parë. 31

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënive me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së znj. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, me relator z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Relacioni i radhës lidhet me projektvendimin e propozuar për t’u shqyrtuar ditën e sotme në mbledhje mbi deklarin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së znj. {...}.

Zonja {...} ka qenë në pozicionin e këshilltares ligjore (ndihmëse ligjore) në Gjykatën e Lartë. Ka filluar marrëdhënien e punës pranë Gjykatës së Lartë në vitin 2014.

Me Urdhrin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, nr. {...}, datë 06.10.2017 “Për lirim nga detyra”, është vendosur: “Lirim e znj. {...} nga detyra e ndihmëses ligjore, pasi ka përfunduar afati i kontratës së punës, me mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, z. {...}, pranë të cilit ka punuar si ndihmëse ligjore.”

Zonja {...}, në datën 22.02.2019 i është drejtuar me kërkesa Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke i kërkuar specifikisht rikthimin në pozicionin e punës këshilltare ligjore pranë Gjykatës së Lartë ose vendeve analoge me të. Gjithashtu kërkesja kishte paraqitur padi edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, padi e cila kishte si kërkim po rikthimin në pozicionin e punës si këshilltare ligjore.

Në këto kushte, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 259, datë 23.07.2020 vendosi fillimisht ndër të tjera: “1. Pëzullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga znj. {...}, për rikthimin e saj në funksionin e Këshilltarit të Gjykatës së Lartë për shkak se kërkesa është në shqyrtim përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë...”

Më tej çështja shkoi për kompetencë në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative dhe përfundoi në fund me vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, i cili me vendimin e datës 07.06.2021 ka vendosur:

“1. Ndryshimin e vendimit nr. {...}, datë 07.06.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

2. Pranimin e padisë.

3. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrin nr. {...}, datë 06.10.2017 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

4. Kthimin në detyrën e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë të paditëses {...}.

5. Detyrimin e palës së paditur Gjykata e Lartë për pagimin e pagës për periudhën 14.10.2017 deri në ditën e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor.

[...]” Ndërmjet të tjerave ka edhe pika të tjera që ky vendim përbën titull ekzekutiv” dhe afati i ankimit.

Znj. {...} në vijim të kërkesave të mëparshme drejtuar Këshillit, me kërkesat e mëtejshme të datës 07.09.2022 dhe 23.06.2022 ka kërkuar ekzekutimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës Administrative të Apelit.

Këshilli, në vijim, me vendimin nr. 455, datë 02.11.2022, pasi ka marrë edhe

shkresat e zonjës {...}, në përputhje me nenin 68/2 të Kodit të Procedurave Administrative, vendosi: “1. Shfuqizimin e vendimit nr. 259, datë 23.07.2020 të KLGJ-së “Për pezullimin e shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}.” 2. Vijimin e procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}”. Ky vendim u mor në kushtet kur shkaqet e ekzistencës së tij kanë pushuar së ekzistuari, pra shkaqet e pezullimit.

Më tej në relacion gjenden edhe shkaqet e arsytimit të vendimit të Gjykatës së Apelit duke treguar arsyet pse zonja {...} duhet të kthehet në detyrë. Unë nuk po i lexoj. Janë të pasqyruara në relacion. Po kaloj tek vlerësimi i Komisionit në relacionin e paraqitur.

Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është një vendim i formës së prerë, që përbën titull ekzekutiv.

Në kushtet kur çështja gjyqësore ka marrë formë të prerë, është vendi që Këshilli të përfundojë procedurën e tij lidhur me kërkesën e paraqitur nga znj. {...}.

Nga përmbajtja si edhe dispozitivi i vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit, rezulton se nëpërmjet këtij vendimit ka marrë zgjidhje kërkesa e znj. {...} për rikthimin në detyrë si Këshilltare Ligjore në Gjykatën e Lartë. Ky vendim disponon kthimin e paditëses në detyrën e saj si këshilltare ligjore pranë Gjykatës së Lartë si palë e paditur, duke i paguar asaj (nga pala e paditur që është Gjykata e Lartë) edhe pagën për kohën e qëndrimit pa e ushtruar detyrën deri në ekzekutimin e këtij vendimi, duke detyruar palën e paditur Gjykatën e Lartë me ekzekutimin e pagesës, duke nënkuptuar në këtë rast edhe ekzekutimin e vendimit. Në këto rrethana kërkesa e znj. {...} mbetet pa objekt për t’u trajtuar nga Këshilli.

Prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të kërkesës pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenet 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, rregullimet e të cilit duhen zbatuar nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga Ligji nr.115/2016.

Sipas nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, rezulton se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi.

Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Sipas nenit 97/3 të Ligji nr.115/2016, rezulton se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”.

Këshilli në këtë rast është i detyruar të deklarojë përfundimin e procedurës pa vendim përfundimtar mbi themelin e çështjes, pasi kërkesa e kërkueses znj. {...} në kushtet kur është zgjidhur tërësisht nga Gjykata Administrative e Apelit mbetet pa objekt.

Bashkëlidhur relacionit ne kemi paraqitur edhe projektvendimin sipas të cilit, në paragrafin e parë të të cilit ne kemi propozuar:

Të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, shqyrtimi i kërkesës së znj. {...}, për shkak se kjo kërkesë është zgjidhur me vendimin nr. 264/2022, datë 23.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Në këtë rast është vendi që unë të propozoj edhe një plotësim të projektvendimit të propozuar.

Kur bëhet fjalë për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesës së znj. {...}, ne i referohemi kërkesës konkrete që ajo i ka paraqitur, të përmendur në këtë relacion, fillimisht Këshillit të Lartë Gjyqësor, që është kërkesa për rikthimin e saj në funksionin e këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë.

Pra propozojmë që kjo fjali e përmendur në paragrafin e parë të dispozitivit të propozuar nga Komisioni, të rindërtohet/rirregullohet në këtë mënyrë.

“1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së znj. {...}, (shtesa) “për rikthimin e saj në funksionin e këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë”, për shkak se kjo kërkesë është zgjidhur me vendimin nr. 264/86-2022-368, datë 23.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.

Pika e dytë e vendimit ne propozojmë të miratohet siç e kemi propozuar, pra:

“2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit

98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.”

Ky vendim të hyjë në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këto janë propozimet, së bashku edhe me shtesën e bërë në fund të relacionit të prezantuar përpara mbledhjes. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime për sa u parashtrua, së bashku me një shtesë të pikës 1 të këtij projektvendimi të bërë po nga relatori z. Kurushi?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime vazhdojmë me votimin e projektvendimit, duke marrë në konsideratë edhe propozimin e fundit të z. Kurushi.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për deklarinimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së znj. {...}”.

Këshilli i Lartë gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës së znj. {...}, për rikthimin e saj në pozicionin e këshilltares ligjore në Gjykatën e Lartë, për shkak se kjo kërkesë është zgjidhur me vendimin nr. 264/86-2022-368, datë 23.06.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Ky vendim të hyjë në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).²

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 17:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. <i>Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| 2. <i>Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 3. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 4. <i>Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 5. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 6. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 8. <i>Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |

² Sipas rendit kjo çështje renditet nr.7. Pika 5 e rendit shtyhet. Shih procesverbalin e pikës së parë. 38

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me shqyrtimin e një pikë tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej fjalën relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 67 të Ligjit nr. 96/2016, me vendimin nr. 223, datë 08.05.2023, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të mundësisë

fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}”, ka vendosur “1. Fillimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës. 2. Të ngarkojë Komisionin e Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për efekt të kësaj procedure.”

Ky vendim u mor pasi Këshilli u njoh me raportet mjekësore të njëpasnjëshme, të vëna në dispozicion nga gjyqtari {...}, në funksion të shqyrtimit të procedimeve disiplinore nr. 3/2022, nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023 të filluara sipas kërkesave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në vijim të vendimit të mësipërm të Këshillit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës filloi procedurën e verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit duke mbledhur dokumentacionin e nevojshëm nga institucionet përkatëse, respektivisht nga Spitali Rajonal Shkodër dhe Shërbimi i Shëndetit Mendor Shkodër.

Në vijim janë disa rrethana të cilat ne mendojmë se pengojnë vijimin e kësaj procedure verifikimi:

KMCAP-i (Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë) Shkodër, nëpërmjet vërtetimit të datës 13.07.2023, ka bërë me dije se: “...me vendimin nr. {...}, datë 13.07.2023 cakton se z. {...} plotëson kushtet për të fituar të ardhura për shkak të invaliditetit të plotë, nga data 19.06.2023-30.06.2024...”.

Vlerësimi i Komisionit:

Rrethanat e faktit të konstatuara që i referohen vendimit të përmendur më lart, të KMCAP-it Shkodër, janë të rëndësishme për të përfunduar pa një vendim përfundimtar procedurën e Këshillit për verifikimin e mundësive fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}, të filluar me vendimin e datës 08.05.2023.

Në rastin objekt shqyrtimi, vendimi i KMCAP-it, i cili përcakton se z. {...} plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të plotë, pasi vuan nga një sëmundje e përcaktuar në këtë raport dhe është i paaftë për punë, është shkak i mjaftueshëm për të vijuar procedurën tonë administrative dhe për të propozuar këto propozime që ne i kemi bashkëlidhur projektvendimit, së bashku me këtë relacionin që unë po relatoj përpara Këshillit.

Prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarin e përfunduar të kërkesës/procedurës pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenet 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”.

Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi.

Struktura e projektvendimit:

Projektvendimi është i strukturuar në dy pika, pika e parë e të cilit bën fjalë për deklarin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, z. {...}.

Pika e dytë e vendimit: Një kopje e arsyetuar e tij t’i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Së fundi, parashikohet edhe fakti që ky vendim të hyjë në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, të vazhdohet me votimin e projektvendimit.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}”.

Këshilli i Lartë gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarës {...}, (relatore znj. Yllka Rupa).³

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 17:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

³ Sipas rendit kjo çështje renditet nr. 8. Pika 5 e rendit shtyhet. Shih procesverbalin e pikës së parë. 43

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 7. {...}, gjyqtare.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarës {...}, (relatore znj. Yllka Rupa).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarës {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga zonja Rupa. Gjyqtarja {...} është njoftuar që ky vlerësim do të shqyrtohet sot dhe ka shprehur kundërshtime dhe njëkohësisht edhe vullnetin e saj për të qenë prezent në këtë mbledhje plenare ku do të shqyrtohet vlerësimi i saj.

Ndërkohë, për shkak të lëvizshmërisë së anëtarëve të KLGJ-së prezent në mbledhje, ndërpritet 5 minuta mbledhja, me rikthimin e tyre.

(Pas disa minutash pushim, rifillon mbledhja plenare, ku në sallë është prezent edhe gjyqtarja zonja {...}.)

Ilir Rusi: Pas pushimit të nevojshëm për një rifillim efektiv të mbledhjes, vazhdojmë me mbledhjen e ditës së sotme plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Siç e theksova në mbylljen e shkurtër të kësaj mbledhjeje që u rifillua, do vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtares {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni nga zonja Rupa. Njëkohësisht bëj me dije Këshillin e Lartë Gjyqësor që znj. {...} është njoftuar me e-mailin për mbajtjen e kësaj mbledhjeje plenare dhe shqyrtimin e këtij rendi dite, gjithashtu zonja {...} ka shprehur dëshirën për të qenë prezent në këtë mbledhje për shkak edhe të kundërshtimeve që ka.

Në vijim të procedurës fjala fillimisht për relatoren znj. Rupa dhe pastaj për znj. {...} në lidhje me kundërshtimet e saj.

Yllka Rupa: Faleminderit!

Të nderuar kolegë!

E nderuar zonja {...}!

Në cilësinë e relatores në procedurën e vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, gradimi për gjyqtaren, do të paraqes projektraportin e vlerësimit që ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtares e cila ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

Në projektraport, në mënyrë të detajuar paraqitet e plotë procedura e ndjekur, burimet e vlerësimit dhe evidentimi i të dhënave që rezultojnë prej tyre, konkluzionet lidhur me to si dhe propozimet për nivelin e vlerësimit dhe pikëzimit për çdo kriter.

Do parashtoj në mënyrë të përmbledhur rezultatet lidhur me nivelin e vlerësimit dhe të pikëzimit për të katër kriteret dhe komponentët përbërës.

Gjyqtarja ka paraqitur mosdakordësi lidhur me vlerësimin dhe pikëzimin në tre komponentë. Kundërshtimet e paraqitura prej saj unë do t'i paraqes në mënyrë të plotë

gjatë analizës së këtyre treguesve në tërësi.

Në lidhje me “Aftësitë profesionale të gjyqtarës”, këto pikëzohen sipas dy aspekteve: “Njohuritë ligjore” dhe “Arsyetim ligjor”, të cilat ndahen në disa nëntregues dhe ka rezultuar se në të dyja këto aspekte gjyqtarja shfaq aftësi të larta profesionale, kështu që në të gjithë treguesit propozohet niveli maksimal i pikëzimit. Më konkretisht, në lidhje me “Aftësinë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këto kushte propozohet që në lidhje me këtë nëntregues niveli i vlerësimit të jetë shumë i lartë, pikëzimi 25 pikë.

Sa i takon “Aftësisë për të interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes”, mbështetur në burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimit, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën e Gjykatës Kushtetuese, praktikën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat të Njeriut, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Për këtë arsye propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Për të kaluar në treguesin tjetër “Arsyetimi ligjor”, për sa i përket “Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit gjyqësor. Kështu që propozohet edhe në komponent niveli i pikëzimit maksimal me 15 pikë.

Sa i takon “Strukturës së qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit gjyqësor”, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit, e cila është e dukshme në aspektin vizual dhe të përmbajtjes, duke i dhënë qëndrueshmëri dhe kuptueshmëri vendimit. Ndjekja e një strukture të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecures logjike, nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, orienton drejt dhe saktë lexuesin

lidhur me përmbajtjen e tij. Propozohet në lidhje me këtë tregues niveli i pikëzimit me 10 pikë.

Për sa i takon “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse. Propozohet edhe në lidhje me këtë nëntregues niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi me 25 pikë.

Kështu që propozimi për kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarës” propozohet të jetë niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i takon “Aftësive organizative të gjyqtarës”, të cilat vlerësohen në aspektin e respektimit të afateve ligjore dhe të kryerjes së procedurave gjyqësore.

Në lidhje me “Respektimin e afateve ligjore”, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short, vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja, vendimeve të administruara me indicie nga KPK.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes, konkretisht: Çështja e kategorisë kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake, parashikohet si afat ligjor për përfundimin e gjykimit afati 48 orë nga momenti i regjistrimit të kërkesës në gjykatë, sipas nenit 259/5 të K.Pr.Penale. Rezulton se çështja është përfunduar brenda afatit ligjor.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk

japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër pra një çështje për të cilën parashikohet afat ligjor dhe nuk rezultojnë që gjyqtarja të ketë shkëlqur afatin ligjor për përfundimin e saj, propozohet vlerësimi i gjyqtarës sipas përqindjes matematikore 0-10% e cila përkon me nivelin e vlerësimit maksimal 15 pikë, që është vlerësimi maksimal në lidhje me këtë nëntregues.

Në lidhje me “Plotësimin e standardeve minimale kohore”, nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se në çështjet e vëzhguara gjykimi në përgjithësi ka përfunduar brenda standardeve minimale kohore. Kështu nga 14 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, rezultojnë se 4 (katër) prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard minimal kohor të përcaktuar për secilën kategori. Pra në total 28.6 % të çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor. Ky rezultat përkon me një nivel vlerësimi prej 3 pikësh. Projektraporti, nga ana tjetër, analizon në mënyrë të detajuar ecurinë procedurale të këtyre çështjeve, shkallën e kompleksitetit, veprimet e kryera nga gjyqtarja për të përfunduar gjykimin e shpejtë të çështjeve si dhe elementë të tjerë të cilët kanë çuar në mosrespektimin e standardit minimal por që nuk varen nga gjyqtarja.

Për këtë arsye, duke marrë në konsideratë edhe këto aspekte, unë propozoj që në lidhje me këtë nëntregues, gjyqtarja të vlerësohet në nivelin maksimal me 5 pikë.

Për sa i takon “Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, referuar analizës së akteve të vlerësimit, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjysmën e kategorive të çështjeve. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 3 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, tejkalohet vetëm për një kategori (civile themeli), me 2 (dy) muaj, ku duhet të llogaritet muaji gusht gjatë të cilit gjyqtarët janë me leje të zakonshme, festat zyrtare, dhe numri i çështjeve të përzgjedhura është më i lartë se gjysma tjetër e kategorive të çështjeve (penale themeli), si dhe duke iu referuar menaxhimit të kohës dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga gjyqtarja lidhur me gjykimin e kësaj kategorie çështjesh, vlerësoj se ky tregues duhet të pikëzohet me nivelin maksimalisht me 5 pikë.

Në lidhje me “Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 84,31%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 4 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: “Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.” Bazuar në këto përcaktime të metodologjisë, në cilësinë e relatores kam vlerësuar se gjyqtarja duhet të rritet në dy nivele vlerësimi dhe të shkojë në një nivel pikëzimi prej 8 pikësh, duke marrë në konsideratë edhe standardet e mbajtura përgjithësisht nga Këshilli në raste të tilla.

Në lidhje me këtë nëntregues gjyqtarja ka paraqitur kontestime. Gjyqtarja kërkon pikëzimin maksimal të këtij treguesi, pra me 10 pikë dhe për këtë ka paraqitur kundërshtimet të cilat unë po i citoj në mënyrë të përmbledhur pasi gjithsecili nga ju është njohur në momentin që këto kundërshtime kanë ardhur dhe janë paraqitur në Këshill.

Së pari, gjyqtarja ka pretendime lidhur me mënyrën e përlllogaritjes së rendimentit. Duke cituar gjyqtaren “Ky rendiment nuk është llogaritur duke iu referuar standardit të miratuar, por i është referuar ngarkesës me dosje të caktuara e cila e tejkalon disa herë normën e standardit. Së dyti, në projekt-raport më është njohur si punë efektive 2 vjet 1 muaj e 6 ditë punë për periudhën e vlerësimit, ndërsa për vitin 2014 koha ime efektive është 10 muaj e 17 ditë kalendarike e për rrjedhojë edhe rendimenti duhet të përlllogaritet mbi këtë periudhë efektive. Së treti, metodologjia duhet aplikuar për periudhën efektive të punës (2 vjet 1 muaj e 6 ditë).” Gjyqtarja ndër kohë ka bërë edhe llogaritjet e veta duke referuar në numrin e çështjeve të marra në raport me standardin e miratuar. “Së katërti, rendimenti është përlllogaritur mbi bazën e çështjeve të marra dhe çështjeve të përfunduara, por ndërkohë numri i çështjeve të marra është disa herë më i

madh se standardi i miratuar. Në vitin 2014 (pohon gjyqtarja) më janë caktuar 424 çështje civile pra 2,12 herë më shumë se standardi. Në 2015 më janë caktuar 599 çështje, pra 2,995 herë më shumë se standardi. Në 2016 më janë caktuar 35 çështje pra 1,65 herë më shumë se standardi. Për periudhën e vlerësimit më janë caktuar 1058 çështje, ndërsa sipas standardit duhet të më ishin caktuar 421,2 çështje, pra rezulton të jem ngarkuar me 2,5 herë më shumë se norma e miratuar, - pohon gjyqtarja.

Gjithashtu gjyqtarja ka parashtruar edhe disa situata objektive të cilat pohon se kanë ndikuar në rendimentin e punës, të tilla si koha e përfshirjes në procedurat e shortit, që është disa ditë pas emërimit në detyrë, pra përkatësisht 19 ditë në janar të 2014; mospasja e dosjeve të mbartura nga viti 2013, duke qenë se është emëruar në detyrë në vitin 2014; pamundësia për të shpallur vendime në tremujorin e parë të vitit 2014; shortimi në katër muajt e fundit të 2014 pothuaj të gjysmës së ngarkesës; rritja e numrit të çështjeve në korrik të 2014 për shkak të rishortimit pasi nga gjykata është larguar një gjyqtare; gjithashtu edhe periudha e trajtimit me raportin e barrë lindjes që fillon nga 01.03.2016.

Në lidhje me sa parashtron gjyqtarja, pikësëpari më duhet të sqaroj në lidhje me llogaritjen e rendimentit si tregues i cili është kundërshtuar në lidhje me nivelin e pikëzimit. Rendimenti i përfundimit të çështjeve është një përcaktim ligjor dhe nuk ka paqartësi lidhur me mënyrën se si do të përlllogaritet dhe se si do të vlerësohet.

Rendimenti i përfundimit të çështjeve për një magjistrat është raporti i numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara prej tij me numrin e çështjeve gjyqësore të caktuara brenda një viti kalendarik. Ky është parashikimi ligjor, pra neni 2, pika 1 e ligjit “Për statusin”. Nga ana tjetër standardet minimale që citon gjyqtari janë thjesht orientuese në kuptimin që gjyqtari i dhomës civile seksionit të përgjithshëm duhet të gjykojë jo më pak se 120 çështje në një vit që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare. Pra standardi sasior nuk është një kriter në lidhje me rendimentin si raport, por thjesht në lidhje me nivelin e pikëzimit maksimal të treguesit “rendimenti i punës” në qoftë se standardi kalohet në masën 50 % të tij.

Për sa i përket çështjeve që janë me palë kundërshtare, në rastin konkret rendimenti i përfundimit të çështjeve që rezulton të jetë 84,31 % dhe që vlerësohet me 4

pikë sipas metodologjisë është llogaritur si raport i numrit të çështjeve të përfunduara nga gjyqtarja me numrin e çështjeve që janë caktuar gjatë periudhës së vlerësimit. Në lidhje me këtë tregues është vlerësuar që gjyqtarja të mos pikëzohet në nivelin e 4 pikëve, por të ngrihet me dy nivele pasi janë marrë dhe analizuar të gjithë ato elementë që vetë gjyqtarja ka parashtruar në kundërshtimet e saj, gjithashtu, duke u mbështetur edhe në orientimet e metodologjisë për të shmangur në rrethana që nuk varen nga gjyqtari por që pengojnë punën e tij dhe që mund të cenojë një vlerësim objektiv të gjyqtarit.

Kështu që unë edhe në pozitën e relatores në këtë proces vlerësues, mendoj që gjyqtares i është bërë një vlerësim shumë objektiv lidhur me treguesin “Rendimenti në punë” duke u rritur me dy nivele pikëzimi por në pamundësi për të shkuar në nivelin maksimal për arsye sepse akti normativ parashikon kriterin pengues kur përcakton se gjyqtari mund të shkojë në një nivel pikëzimi maksimal vetëm nëse ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin është mbajtur në konsideratë pikësëpari koha efektive në detyrë duke përllogaritur qoftë edhe një ditë pune të gjyqtares, ngarkesa e gjyqtares, mënyra e caktimit të çështjeve me short parë në aspektin kohor dhe mundësisë eventuale të përfundimit të tyre, ngarkesa me dosje gjyqësore në muajin e fundit.

Në lidhje me vitin 2016 gjyqtarja pretendon se rendimenti në punë duhet të llogaritet 100% pavarësisht se ushtrimi efektiv i detyrës nga ana e gjyqtares është më pak se 2 muaj për shkak të raportit të barrë lindjes. Referuar parimit të objektivitetit, parashtron gjyqtarja, rendimenti duhet të llogaritet në masën 100 %.

Vlerësoj se duke qenë se rendimenti në punë është një tregues që përllogaritet mbi bazën e të dhënave konkrete që dalin nga burime vlerësimi, çështje të gjykuara në raport me ato të caktuara, kjo nuk lë vend për të cenuar parimin e objektivitetit pasi kemi të bëjmë me të dhëna të matshme dhe për më tepër në kushtet kur gjyqtarja është në kushtet e një raporti paaftësie të barrë lindjes, pra nuk mund të hamendësojmë ose të përllogarisim këtë rendiment në nivelin 100% duke qenë se nuk ushtron në mënyrë efektive detyrën.

Në këto kushte dhe për sa parashtrova, propozoj që në lidhje me këtë komponent

nuk ka vend për rritjen e pikëve, kështu që i përmbahem propozimit tim fillestar për të pikëzuar rendimentin në punë të gjyqtarës në nivelin e 8 pikëve.

Për sa i takon “Kohës mesatare të arsyetimit të vendimit gjyqësor”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit koha mesatare e arsyetimit të vendimit rezulton më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve kështu që propozohet niveli maksimal i pikëzimit në lidhje me këtë nënkriter.

“Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedura gjyqësore”, në lidhje me “Numrin mesatar të seancave për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, në tërësi rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 10 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare penale themeli, civile themeli, varion nga 1 deri në 18 seanca gjyqësore (përfshirë edhe ato përgatitore). Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 5 (pesë) seanca gjyqësore në çështjet civile me palë kundërshtare (duke përjashtuar seancat përgatitore), 3 (tre) seanca gjyqësore në çështje penale themeli. Në total numri mesatar i seancave është 4.4 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve.

Nga vëzhgimi i 10 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile dhe penale themeli me palë) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal.

Sa më sipër, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura, pavarësisht se rezulton që numri i seancave gjyqësore për çështje të jetë më i lartë se tre, duke marrë në konsideratë edhe ato çfarë parashtrova, kam vlerësuar që në lidhje me këtë komponent gjyqtarja të pikëzohet në nivel maksimal vlerësimi, prej 15 pikësh.

Për sa i takon “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, gjithashtu duke iu referuar të dhënave, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë aftësie në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara, si dhe në orientimin e palëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim, ku

në dy çështje civile konflikti është zgjidhur me pajtim midis palëve. Në lidhje me këtë nënkriter propozoj gjithashtu një nivel vlerësimi në kuotën e 20 pikëve.

Për sa i takon “Aftësisë së gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore”, në të dyja aspektet, si në aspektin e rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes ashtu edhe në aspektin e saktësisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes, vërehet një kujdes shumë i mirë i gjyqtarës, prandaj propozohet pikëzimi për të dy këto nëntregues në nivel pikëzimi maksimal, pra 5 dhe 10 pikë.

Kështu që, në lidhje me kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarës”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikëzimi 91.

Për sa i takon “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, “Etika në punë”, “Angazhimi dhe përgjegjshmërinë në funksion”, referuar burimeve të vlerësimit, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Prandaj propozohet vlerësimi me 35 pikë.

Sa i takon “Integritetit të gjyqtarës”, “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, edhe për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj, propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 40.

“Paanësia e gjyqtarës”, “Përdorimi ose i gjuhës diskriminuese”, rezulton gjithashtu gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, edhe ky tregues vlerësoj të pikëzohet në nivelin maksimal, vlerësimi shumë i lartë.

Për sa i takon “Numrit tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës”, nuk rezulton, pra nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës. Prandaj për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm. Propozohet niveli i pikëzimit prej 15 pikësh.

Kështu që, edhe në lidhje me kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, gjyqtarja {...} vlerësohet në nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për të kaluar tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, “Aftësia e komunikimit”, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën që përdor në arsyetimin e vendimeve. Propozohet niveli i pikëzimit 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, gjyqtarja gjithashtu ka treguar kujdes maksimal në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Propozohet niveli i vlerësimit me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar” si për sa i takon shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me to, ashtu edhe shkallës së komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, në të dy këto komponentë gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të pikëzimit.

“Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, në mënyrë të veçantë pjesëmarrja e saj në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale është pikëzuar në nivelin maksimal për arsye sepse referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit të sjella nga Shkolla e Magjistraturës, gjyqtarja {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses në 11 aktivitete trajnuese të zhvilluara për gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 21 ditë trajnimi dhe rezulton gjithashtu se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnimin jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, i cili rezulton të jetë aktivitet i formimit profesional. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në: Kursin trajnues të anglishtes ligjore për gjyqtarë, i zhvilluar nga muaji shkurt 2013 deri në muajin korrik 2014, organizuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit, Ambasada Amerikane në Tiranë, si dhe në trajnimin jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës - trajnimi i organizuar nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, me temë “Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe praktikat

gjqësore lidhur me fyerjen dhe shpifjen”, zhvilluar në datat 3-4 korrik, 2014.

Për sa i takon “Disponueshmërisë së gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lehtësuese dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional. Prandaj është vlerësuar në nivelin e 3 pikëve, jo në nivelin maksimal prej 5 pikësh.

Gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime lidhur me vlerësimin e këtij treguesi me 3 pikë dhe parashtrohet arsyet të cilat ajo i konsideron të arsyeshme për ta kualifikuar në nivel vlerësimi prej 5 pikësh.

Gjyqtarja parashtrohet se për periudhën e vlerësimit kam treguar gatishmëri për pjesëmarrjen aktive në trajnime të tjera, të organizuara në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin e gjyqtarëve lidhur me anglishten ligjore dhe jo vetëm. Gjyqtarja pohon se: “Kam qenë së pari në rolin e lehtësueses efektivisht (pavarësisht se si pozicion për Shkollën e Magjistraturës është ligjërues më vonë) si dhe 2) jam ofruar për të udhëhequr me asistencë legjislative të vendit tonë një student amerikan në Shqipëri”. Lidhur me këto parashtime gjyqtarja ka paraqitur edhe përmbajtjen e korrespondencës elektronike, e-mailin me organizatorët, që është një e-mail kryesisht lidhur me përmbajtjen vlen ai i datës 21 korrik 2014, në përmbajtjen e të cilit rezulton se gjyqtarja ka pasur cilësinë e koordinatorës së gjyqtarëve në një takim për të diskutuar rreth problematikave të sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Gjithashtu gjyqtarja pohon se duke qenë një projekt dinamik gjatë të cilit jo vetëm që jemi trajnuar për anglishten ligjore por jam aktivizuar edhe në pozicionin e lehtësueses për organizatorët e projektit në kuadër të zhvillimit të takimeve të ndryshme profesionale. Vlerësoj se këto aktivitete nuk duhet të trajtohen vetëm në njërin nga komponentët e vlerësimit, - pohon gjyqtarja, -pasi ato janë të trajtuara, janë marrë në nivelin e pikëzimit tek seksioni 4.C. por edhe në pikëzimin e treguesve “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” dhe gjithashtu edhe në lidhje me treguesin tjetër “Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”.

Në lidhje me sa parashtron gjyqtarja, nga përmbajtja e e-maileve, pavarësisht se e-mailët nuk përbëjnë, në kuptimin e akteve normative që vlerësojnë gjyqtaren, nuk përbëjnë burime vlerësimi, nga përmbajtja e e-maileve të paraqitura, rezulton se gjyqtarja ka ndjekur një kurs profesional për anglishten ligjore i cili në bazë të e-maileve rezulton të ketë filluar në vitin 2012, rezulton të jetë një iniciativë e Shkollës së Magjistraturës dhe mbështetet nga një pedagoge e anglishtes ligjore rezidente në Shqipëri. Në kuadër të këtij kursi janë organizuar edhe disa aktivitete por që sipas e-maileve qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve ka qenë ripërsëritja e njohurive të terminologjisë juridike në gjuhën angleze. Kjo rezulton nga përmbajtja e e-mailit që mban datën 26 nëntor 2012. Gjithashtu, sipas një e-maili tjetër të datës 14 janar 2014 rezulton se është kërkuar për gjyqtaren por edhe për të gjithë grupin që përbëjnë klasën e anglishtes për të asistuar me ndihmë juridike një student amerikan i cili trajtohej me bursë të plotë nga Departamenti i Shtetit Amerikan dhe rezulton që gjyqtarja të shikojë mundësinë e ofrimit të një asistence të tillë për studentin.

Sipas një e-maili të paraqitur nga gjyqtarja që mban datën 21 korrik 2014 rezulton se ka marrë përsipër të jetë personi i kontaktit për gjyqtarët që do të jenë pjesë e aktivitetit për të diskutuar rreth çështjeve të sistemit të drejtësisë.

Në vlerësimin tim, si relatores e kësaj procedure vlerësimi, kurset profesionale, në rastin konkret, kursi për anglishten ligjore dhe aktivitetet që realizohen në kuadër të tij, pra që kanë një qëllim të përcaktuar dhe që është përmirësimi i njohurive të gjuhës së huaj, nuk mund të trajtohen si trajnime të tjera në kontekstin e disponueshmërisë së gjyqtarit për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional ose për trajnimin e gjyqtarëve dhe as të vlerësohen si veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Metodologjia e pikëzimit përcakton qartë rolin e ekspertit apo lehtësuesit në trajnimin fillestar apo vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, aq më tepër në bazë të e-maileve që paraqet gjyqtarja me cilësinë e provës, nuk rezulton që të ketë dhënë kontribut si eksperte apo lehtësuese, por po të pranojmë logjikën me gjyqtaren që ky rol nuk është njohur asokohe nga Shkolla por është një koncept i referuar në ligjin “Për statusin”, por thjesht rezulton të jetë personi i kontaktit për gjyqtarët që janë pjesë e klasës së

anglishtes.

Gjithashtu nuk rezulton e qartë që gjyqtarja të ketë asistuar studentin amerikan por edhe po të rezultonte i saktë një fakt i tillë, pikëzimi i gjyqtares lidhur me këtë tregues, i referohet vetëm kontributit që ato japin, pra të gjithë gjyqtarët, duke qenë mentorë, kandidatëve për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, madje kur plotësojnë kriteret dhe kushtet për një gjë të tillë siç parashikon ligji, edhe trajnimet pra mendoj që i referohen kuptimit të ligjit, i referohen thjesht trajnimeve që bëhen në kuadër të studentëve që ndjekin Shkollën e Magjistraturës.

Nga ana tjetër, lidhur me kontributin e gjyqtarit në veprimtari profesionale, përsëri metodologjia parashikon se cilat janë veprimtaritë që lidhen me përmirësimin e sistemit të drejtësisë, janë veprimtari jashtë funksionit me ose pa pagesë, të tilla pra si fjalime publike, prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit për çështjet e drejtësisë; bashkëpunimi me institucionet e drejtësisë apo tryeza të rumbullakëta, etj. si këto. Në këto kushte nuk rezulton që gjyqtarja të ketë dhënë kontribut të kësaj natyre (kuptohet) gjatë periudhës së vlerësimit 2013 – 2016.

Propozoj që niveli i pikëzimit të mos ndryshohet lidhur me këtë nëntregues dhe gjyqtarja të pikëzohet me 3 pikë.

Për sa i takon “Angazhimit të gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjithashtu pikëzimi për ato çfarë unë parashtrova propozohet të jetë në nivelin e 3 pikëve.

Në lidhje me “Publikimet ligjore akademike”, nuk rezulton që zonja {...} të ketë paraqitur të tilla, kështu që nuk vlerësohet në lidhje me këtë nëntregues.

Kështu që edhe niveli i vlerësimit dhe i pikëzimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” nuk propozoj ndonjë ndryshim. Mbetem për nivelin e vlerësimit "Shkëlqyeshëm" dhe pikët 91.

Në lidhje me propozimin për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit dhe të pikëzimit për këtë procedurë vlerësimi për periudhën 2013 – 2016, për gjyqtaren {...}, propozoj në lidhje me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm"; “Aftësitë organizative të gjyqtares”, pikët 91, niveli i vlerësimit

"Shkëlqyeshëm"; "Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale", pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm"; "Aftësitë personale dhe angazhimi profesional" pikët 91, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Kështu që propozimi për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është pikëzimi 382, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm". Faleminderit për vëmendjen!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa!

Do ftoja gjyqtaren znj. {...} për të shprehur kundërshtimet e saj. Për të qenë racional, të përqendrohet tek ato rubrika për të cilat ka një vlerësim më pak se maksimalja dhe duke shprehur dhe kundërshtimet dhe opinionet tuaja.

{...}: Faleminderit!

Do më lejoni fillimisht të falenderoj Komisionin e Vlerësimit, se pavarësisht se evidentohen kundërshtime, saktësime, unë konstatoj dhe vlerësoj se është bërë një punë serioze në të dyja vlerësimet dhe dua të falenderoj edhe relatorët. Pavarësisht se paraqitja e kundërshtimeve të mia ka ardhur pikërisht për faktin se unë e kam marrë shumë seriozisht edhe punën që është bërë por kam vlerësuar edhe punën që unë kam kryer në praktikë dhe jam koshiente se nëse vlerësohet gjyqtari me statistika, normalisht statistikat duhet të jenë të gjalla, duhet të matim gjyqtarin konkret. Se mund të merren parasysh disa rrethana objektive që dihen përgjithësisht për gjyqtarët por mund të ketë edhe disa rrethana që i ka gjyqtari konkret si individ në punën e vet të përditshme, që normalisht relatori ato nuk ka si ti dijë dhe unë për këtë arsye i kam parashtruar, pavarësisht se termi "kundërshtime" tingëllon pak i vrazhdë.

Doja të referoja tek rendimenti. Në fakt, unë ju dëgjova, pikërisht tek ajo pikë, ju dëgjova me shumë vëmendje dhe unë prapë nuk e di se cila është norma që unë atë vit duhet të mbyllja çështje.

Yllka Rupa: E sqaron ligji, është një përcaktim ligjor rendimenti. Ka një formulë që përcaktohet në ligj dhe në bazë të formulës bëhet rendimenti. Është neni 2 i ligjit "Për statusin"

{...}: E kuptoj, është një aneks që është aneksi 1 i sistemit të vlerësimit që e ka miratuar KLD-ja e kohës për mënyrën se si gjyqtari duhet ta ketë në referim.

Yllka Rupa: Akti normativ i KLD-së i referohet standardeve orientuese, sasiore, kohore. Është tjetër gjë.

Ilir Rusi: Atëherë, ju zonja {...} keni paqartësi mbi mënyrën se si bëhet vlerësimi tek rubrika që ka të bëjë me “Aftësitë organizative të gjyqtarëve” dhe konkretisht në lidhje me “Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore”.

{...}: 2.A.ç.

Ilir Rusi: Po! Zonja Ukperaj ka një koment.

Brikena Ukperaj: Edhe unë i kam lexuar kundërshtimet dhe duket, sepse ju shpeshherë i referoni standardit dhe thoni që nëse unë do të kisha gjykuar sipas standardit, nuk do kisha dalë me këtë rendiment.

Rendimenti i përfundimit të çështjeve është një nga indikatorët/treguesit e aftësive organizative. Rendimentin se çfarë është e përcakton ligji. Është raporti midis çështjeve që ti ke zgjidhur (pra vendimeve që ti ke dhënë pavarësisht se kur të është caktuar çështja) me çështjet që të janë caktuar për një vit kalendarik. Ky është rendimenti. Nga rendimenti del një raport: 75, 74, 82, 90. Sigurisht tek gjyqtarët të cilëve u caktohen më pak çështje, rendimenti ka predispozitën të dali lart sepse gjyqtarët e gjykatave të vogla për shembull (pasi nuk varet nga gjyqtari se sa do jetë prurja e çështjeve në gjykatë) kanë pak çështje, mbyllin dhe shumë çështje dhe gjithmonë dalin me rendiment shumë të lartë.

Tani, ç’kemi bërë ne në metodologji?

Për të mbrojtur në një farë mënyre edhe gjyqtarët e gjykatave të mëdha në të cilat prurja e çështjeve është shumë më e madhe dhe sado që të gjykojë gjyqtari, nuk gjykon dot më shumë se aq çështje, futëm indikatorin e standardit dhe thamë që pikëzimin

maksimal (edhe gjyqtarët që e kanë rendimentin 70, 80, pra më të ulët) do ta marrin ata gjyqtarë të cilët kanë të paktën tregues të punës të tillë që kanë mbaruar të themi 200 themeli në vit, kanë mbaruar 150. Prandaj është futur 50%. Pra pavarësisht se sa del rendimenti i gjyqtarit, nëse gjyqtari vetë ka tejkaluar standardin minimal sasior që ka përcaktuar KLD-ja në atë kohë, ai mund të shkojë në një pikëzim maksimal. Por jo se rendimenti duhet të llogaritet me standardin minimal. Më kuptove? Kjo është ideja. Pra ti ke gjykuar “x” çështje dhe ty të janë caktuar “y” çështje dhe rendimenti të del 70%.

{...}: Unë e kuptoj.

Brikena Ukperaj: Nëse ti gjatë kësaj kohe apo çdo gjyqtar ka gjykuar 50% më shumë se standardi, për shembull standardi është 200 themeli në vit, në qoftë se ti ke gjykuar 300 themeli në vit – ne kemi pasur gjyqtarë që e kanë tejkaluar standardin dhe me 200% - atëherë, pavarësisht nga numri i çështjeve që i shkojnë gjyqtarit, sigurisht që ai do të marrë një pikëzim maksimal sepse përcaktuesi i këtij rendimenti duket që ka qenë numri i çështjeve të reja dhe jo aftësia e zgjidhjes së çështjeve të gjyqtarit.

{...}: Unë këtë e kuptova. Por edhe në teorinë ekonomike është shumë e thjeshtë, vendoset norma e punës..

Nuk mundet gjyqtari... më lejoni për mënyrën se si po shprehem sepse kur ka të bëjë me punën, normalisht ti je shumë i ndjeshëm.

Si mund t’i thuash një gjyqtari që ti ke marrë kaq dosje dhe ke hequr kaq dosje, se në fund pastaj gjyqtarit do t’i bësh edhe një remont siç i bën makinave, ndërkohë që gjyqtari është gjyqtar. Me kë e jam në garë unë? Se unë duhet të di me kë e kam garën? E kam garën me standardin.

Irena Plaku: Sapo tha zonja Ukperaj, mënyra e llogaritjes së rendimentit është përcaktuar në ligj. Rregullorja ka parashikuar disa specifika që ne kur të bëjmë vlerësimin, mos i rrimë strikt atij rendimenti që del nga të dhënat statistikore. Po të kemi parasysh garën, meqë po thua garën, ka pasur gjyqtarë që realisht në tre vite periudhë

pune, kanë gjykuar 2000 çështje dhe mund t'i ketë dalë rendimenti 106% (rendimenti). Kështu që, ne nuk nisemi nga gara. Ne nisemi nga ato që tregojnë të dhënat statistikore. Rendimenti është përcaktuar si llogaritjet. Ne s'mund ta llogarisim ndryshe. Analizohen më pas këto të dhëna statistikore, duke pasur parasysh atë standard që ju keni referuar, që është miratuar me vendimin 261/2 të ish-KLD-së, që janë standarde sasiore orientuese minimale (minimalja që duhet të gjykojë gjyqtari, jo më pak). Ndër të tjera, llogaritjet me çështje me palë kundërshtare. Jo të gjitha çështjet. Sepse me çështjet me palë kundërshtare thotë që duhet 200. Por, bashkë me kërkesat, duhet të jetë 400 (po ta lexojmë të gjithë aneksin). Do të thotë që minimumi shkon në 600 në vit, duke pasur parasysh 200 dhe 400 kërkesa, që janë çështje pa palë kundërshtare, shkon në 600. Domethënë numri i çështjeve referon çështje me palë kundërshtare dhe është një standard sasior minimal orientues. Nuk është normë.

{...}: E kuptoj.

Nuk dua të bëj më oponencën. Unë i qëndroj kundërshtimit që kam bërë sepse e kam përllogaritur në bazë të asaj si e kam kuptuar unë metodologjinë. Mos ndoshta mos u ha më tepër kohë, se e di që axhenda është e ngjeshur sot.

Ndërkohë që lidhur me...

Ilir Rusi: Ju lutem, se relatorja ka diçka për të thënë.

Po, zonja Rupa!

{...}: Po! Më fal!

Yllka Rupa: Lidhur me rendimentin, sigurisht që është rritur dy nivele pikëzimi, pra janë marrë në konsideratë të gjitha ato kundërshtime që ju i keni përcaktuar në formatin që i keni paraqitur. Megjithatë (sepse unë nuk e citova), në lidhje me standardin, në vitin 2014 gjithsej keni gjykuar 47 çështje themeli, pra 76,5% më pak sesa standardi i miratuar. Në vitin 2015, 233 çështje themeli, 30% më shumë se standardi. Ndërsa në vitin 2016 keni gjykuar gjithsej 26 çështje themeli ose 18% më pak se standardi i miratuar. Pra

mbështetur në statistikat...

{...}: Standardi i referohet 200 dosje mesatarisht. Normalisht ato si përqindje janë përlogaritur gabim me sa unë kam përlogaritur. I jam referuar saktë projektraportit. Domethënë është përlogaritja matematikore... është nxjerrë përqindja, ndoshta nuk është edhe në favorin tim, por është bërë gabim.

Ilir Rusi: Ju lutem.

Në raport me statusin e prezencës tuaj ju keni ardhur si një magjistrate e cila keni kundërshtime në raport me projektraportin që është paraqitur për vlerësimin tuaj.

{...}: Po!

Ilir Rusi: Ju lutem, vazhdoni me paraqitjen e kundërshtimeve tuaja, duke orientuar sipas rubrikave përkatëse, megjithëse disa rubrika janë ato, për shkak edhe të nivelit të pikëve. Ju lutem, në lidhje me këtë rubrikë keni kundërshtime të tjera, pas edhe këtyre diskutimeve? Që do të thotë, për të qenë më sintetik dhe konciz dhe të qartë, ju vazhdoni të parashtroni kundërshtimet tuaja. Në një moment të dytë, pasi ju të parashtroni kundërshtimet, do të largoheni dhe Këshilli të vazhdojë me diskutimet përkatëse mbi vendimmarrjen.

{...}: Ju falenderoj.

Lidhur tek kriterin 4.C.b (aty ku ka qenë edhe kundërshtimi). Nuk e di, a e kam dorëzuar, a ndoshta nuk është protokolluar, është edhe një e-mail. Unë e kuptoj që nga e-maillet nuk del qartë mënyra se si është zhvilluar aktiviteti sepse Ambasada Amerikane ka pasur marrëveshje ndoshta edhe xhentëlmenësh me Shkollën e Magjistraturës, por normalisht ka qenë një aktivitet shumë serioz dhe nuk ka qenë vetëm fokusi që të përvetësohet gjuha angleze por ka qenë fokusi sepse ka qenë duke kaluar reforma në drejtësi dhe ata kanë dashur të marrin edhe impaktin e gjyqtarëve lidhur me tematika të caktuara. Korrespondenca jonë me profesoreshën ishte nëpërmjet e-mailit. Nuk e dija se

do më duheshe që ta dokumentoja çdo lloj veprimi për ta sjellë ndryshe. E-maili mund të jetë vetëm mënyra se si mund ta dokumentoj, përveç asaj certifikatës që na kanë dhënë në përfundim të aktivitetit. Por lidhur me faktin që unë aty kam kryer rolin e lehtësueses ose rolin e negociatores (se këtë bën edhe lehtësuesi në trajnimet e Shkollës së Magjistraturës), këtë e kam kryer me pasionin e profesionit dhe në ato vite sepse kam qenë gjyqtari më pak i angazhuar në atë periudhë për shkak se nuk kam qenë emëruar. Është një e-mail, nuk e di po është depozituar apo jo, është e 21 korrikut 2014 dhe zonja {...} i është drejtuar zonjës {...} (gjyqtarët e njohin ndoshta) dhe i thotë që {...} është përgjegjëse që të ndjekë skedulin dhe të organizojë gjyqtarët sipas angazhimeve që kanë, se ky është edhe roli që bën lehtësuesi. Tani, unë këtë kam si e-mail, që ka lënë shenjë, se normalisht unë e kryeja në mënyrë vullnetare si aktivitet dhe kështu e kryenin edhe shumë gjyqtarë rolin e ekspertit edhe rolin e lehtësuesit në Shkollën e Magjistraturës dhe nuk është se kishte një procedurë të mirëpërcaktuar nga Shkolla. Ose edhe mentorimet, nëse unë shkoja ndiqja stazhin pranë një gjyqtari, nuk është se kishin një procedurë që këta janë gjyqtarët që ne kemi futur tek lista e mentorimit dhe shkoni ndiqni për atë periudha. Doja ndoshta t'jua depozitoja këtë e-mail. Nuk e di a është apo jo në dosje. Por doja t'ia lija Këshillit.

Lidhur me pjesën tjetër ku nuk mund të konsiderohet që një grup gjyqtarësh kanë pasur impakt në mënyrën se si kanë zhvilluar takime me përfaqësues të Ambasadës Amerikane, unë nuk e di si mund ta dokumentoj, se aty janë zhvilluar takime të ndryshme. Është marrë mendimi i gjyqtarëve për mënyrën se si po merreshin reformat, por këtë pjesë unë nuk kam si ta dokumentoj përveç e-maileve.

Kështu që unë i qëndroj atyre që kam parashtruar me shkrim. Do doja ta depozitoja atë e-mail sepse nuk e di a ndodhet apo jo, ku citohet shprehimisht detyra që ngarkon pedagogia që ishte përgjegjëse dhe i referohet, domethënë ka bërë në “cc”, ia ka dërguar zonjës {...}.

Këto ishin pak a shumë ato saktësime, kundërshtime.

Doja të sillja domethënë prezencën time me ato që kam thënë, të kuptohet qartë figura ime si gjyqtare por edhe figura si profesioniste jashtë punës sime si gjyqtare. Normalisht unë e kam kryer si veprimtari atë, pavarësisht se shumë gjyqtarë mund të mos

kenë dokumente nga ato me vulë noteriale dhe gjithë të tjerat. Kështu që ju falenderoj për këtë pjesën.

Në qoftë se ndonjë pyetje.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}.

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, me sa kam kuptuar, kundërshton vlerësimin ose propozimin që relatorja ka bërë për disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve. Sepse për të njëjtën veprimtari ti mendon që duhet ta përfshijmë edhe tek një indikator, edhe tek tjetri. Konkretisht?

{...}: Unë e kuptoj që të paktën me atë certifikatë që na ka dhënë në fund Ambasada, se ata nuk i kanë mëshuar faktit...

Brikena Ukperaj: Ta mbaroj pyetjen {...}?

Ta mbaroj pyetjen që edhe ne të jemi të qartë dhe të vlerësojmë realisht kontributin që ju keni dhënë.

{...}: Po!

Brikena Ukperaj: Ka disa indikatorë tek kriteri i katërt i aftësive profesionale që bëjnë fjalë për angazhime jogjyqësore të gjyqtarit (jashtë fushës së veprimtarisë). Ju në këtë kohë thatë që e keni që kur keni qenë studente në Shkollën e Magjistraturës. Keni qenë e emëruar gjyqtare në atë kohë?

{...}: Nuk jam emëruar në një pozicion konkret pune, por sipas ligjit të kohës unë konsiderohesha gjyqtare.

Brikena Ukperaj: Pra nuk ke qenë e emëruar në gjykatë.

{...}: Jo!

Brikena Ukperaj: E ke filluar anglishten ligjore që kur ke qenë studente në Shkollën e Magjistraturës. Siç shumë ne na vinte e-maili për të marrë pjesë në kursin e anglishtes ligjore, apo jo?

{...}: Jo, jo, ka qenë trajnim që bëhej për gjyqtarët për anglishten ligjore dhe bëhej për gjyqtarët, jo për studentët, jo për magjistratët që ishin në Shkollë – po i referohem termit siç ka qenë në kohë se sot quhen të gjithë magjistratë). Pra bëhej për gjyqtarët që kishin përfunduar dhe sipas ligjit, në momentin që ne diplomoheshim, konsideroheshim gjyqtarë.

Brikena Ukperaj: E di, sepse ky e-mail i shkonte të gjithë gjyqtarëve për të ndjekur kursin e anglishtes ligjore.

Tani, çfarë kontributi keni ju për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional (dhe kjo gjë duke referuar ligjit “Për statusin”) ose për trajnimin e gjyqtarëve? Konkretisht, kontributi, cili është?

{...}: Kam pasur rolin e lehtësuesit me gjyqtarët dhe organizatorët amerikanë.

Brikena Ukperaj: Lehtësues ku? Në kë trajnim?

{...}: Lehtësues në sensin që unë duhet të organizoja dhe të mblidhja, të mbaja kontakt me gjyqtarët, të organizoja oraret (skedulet se si do ndiqeshin) dhe gjatë kësaj periudhe më kontaktonte mua ajo zonja e ambasadës dhe unë pastaj kisha të gjithë kontaktet e tjera me gjyqtarët dhe koordinoja në çfarë orari do jeni, ku do takohen.

Brikena Ukperaj: Lehtësues për orarin?

{...}: Lehtësuesi në magistraturë këtë bën.

Brikena Ukperaj: Lehtësuesi në magistraturë nuk bën këtë.

Lehtësuesi në një trajnim nuk merret thjesht me organizimin e orareve, apo jo? Lehtësuesi në një trajnim mbledh praktikat gjyqësore. Ka rregullore Shkolla për detyrat e lehtësuesit, detyrat e ekspertit.

{...}: Sot!

Brikena Ukperaj: Sot, edhe në atë kohë ka pasur.

Nejse, se kjo është tjetër gjë. Unë doja thjesht të kuptoja cili ishte kontributi juaj efektiv për ta vlerësuar. Ka mbetur thjesht në koordinimin e të gjithë grupit, oraret, si do të bëhet trajnimi, apo ishte kontribut efektiv në përmbajtje të trajnimit.

{...}: Po kontribut efektiv ka qenë, në përmbajtje të trajnimit, sepse normalisht nëse zonja thoshte do të mbledhësh materiale, praktika, se do t'i trajtojmë aty, dhe unë koordinoja grupin ose gjyqtarët që do ishin, ia u çoja me mesazhe (se me e-maile nuk e mbaje dot të gjithë grupin, që t'i koordinojë).

Brikena Ukperaj: Çfarë praktikash ishin?

{...}: Normalisht ne nuk na jepnin gramatikën në gjuhën angleze. Ne merrnim çështje gjyqësore dhe i diskutonim. Sillte zonja, profesoresha amerikane dhe ndërkohë sillnim edhe ne praktikën tonë, dhe aty diskutonim.

Brikena Ukperaj: Po atë mund ta bënte çdo gjyqtar që ishte pjesë e trajnimit, apo jo?

{...}: Mund ta bënte çdo gjyqtar. Më qëllloi që ta bëja unë.

Brikena Ukperaj: Dakord!

Pse mendon që ke kontribuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë. Është e njëjta gjë?

{...}: Është i njëjti aktivitet.

Nëse ata sillnin përfaqësues të Ambasadës Amerikane dhe një ndër ta e përmend është një përfaqësues i anglishtes për rajonin, që merrte pjesë në Ambasadë, ata pyesnin për mënyrën si do të funksiononte sistemi i drejtësisë, se si e shikonim ne sistemin e drejtësisë, si mendonim ne të rregullohej dhe diskutonim pastaj për praktikën.

Brikena Ukperaj: Pra ka qenë tryezë diskutimi.

Keni bërë ndonjë punim? Keni dhënë ndonjë kontribut efektiv nga ana juaj lidhur me këtë temë?

{...}: Punim konkret, jo!

Brikena Ukperaj: Thjesht keni qenë në tryeza dhe keni shkëmbyer mendime.

{...}: Po!

Brikena Ukperaj: S’kam pyetje të tjera.

{...}: Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ftoj anëtarët e tjerë prezent në mbledhje nëse kanë pyetje apo jo.

(Nuk ka pyetje.)

Meqenëse nuk kanë pyetje, ftoj zonjën {...} të largohet, me qëllim që ne të vazhdojmë me diskutimin në lidhje me vlerësimin e projektraportit për vitet 2013 – 2016.

(Largohet nga salla gjyqtarja znj. {...}.)

Ilir Rusi: Në vijim do të ftoja relatoren zonjën Rupa nëse ka diçka për të thënë në lidhje me sa paraqiti kundërshtimet zonja {...}.

Yllka Rupa: Faleminderit zoti Rusi!

Jo, nuk kam asgjë.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, ftoj anëtarët nëse kanë diskutime pas relatimit/prezantimit nga zonja Rupa, diskutimeve dhe kundërshtimeve të paraqitura nga zonja {...}.

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Sigurisht nuk më bën sens pjesa e ankimit apo përmbajtjes së ankimit që gjyqtarja ka justifikuar pjesën e rendimentit dhe ndoshta e konsideroj se aty ka faktorë të cilët kanë interferuar dhe nuk kanë lidhje me vullnetin e gjyqtarit për të arritur rendimente të tilla që do të kishin në atë kohë edhe meritën e duhur, por kanë qenë të tilla, kanë qenë jashtë vullnetit të gjyqtarit dhe si të tilla nuk mund të penalizohet gjyqtari për faktorë të cilët nuk kanë lidhje me vullnetin e saj.

Të kemi parasysh është një gjyqtare që ka filluar në janar të 2014 dhe direkt është përfshirë në seksionin civil, i cili për nga natyra është një seksion jo vetëm i vështirë, por që gjithmonë vendimmarrjet zgjasin në kohë për shkak të procedurës së cilës ajo realizohet. Natyrisht që nuk mund të kërkosh që në këtë kohë ose të paktën në muajt e parë të këtij viti, të kemi një rendiment të lartë apo vendimmarrje të shumta të gjyqtarit për vetë efektin e procedurës e cila kërkon apo palëve të cilët janë në gjykim, e cila kërkon impenjim dhe kohë për të arritur në finale me anë të një vendimmarrjeje përfundimtare. Po të shikojmë në atë periudhë, duke filluar edhe nga marsi, vendimmarrjet në këtë seksion kanë filluar të shtohen. Në fillim, në shkurt kanë qenë 3, pastaj në mars 10, dhe kështu me radhë, duke arritur në prill në 19 vendime gjyqësore.

Natyrisht, për të arritur në këtë opinion kam vlerësuar dhe mënyrën se si është krijuar portofoli i çështjeve tek kjo gjyqtare. Mund të marrë në konsideratë që në katër muajt e fundit të vitit 2014 asaj i janë shortuar 188 dosje gjyqësore. Natyrisht që një volum/portofol kaq i madh dosjesh gjyqësore nuk të lejon jo vetëm për t'i evaduar në kohë dhe në mënyrë të shpejtë, për vetë faktin që ato bëjnë pjesë në materien civile, natyrisht do të kërkojnë kohën e tyre dhe natyrën e gjykimit të saj. Gjithashtu, në periudha të caktuara, gjyqtarja është ngarkuar me një short të menjëhershëm dhe kam parasysh momentin ku kemi një largim të një gjyqtareje dhe portofoli i saj i ka kaluar të gjithë gjyqtarëve duke bërë që menjëherë të ngarkohet me 18 çështje gjyqësore, të cilat natyrisht do duan kohën e tyre për të relatuar dhe për t'i përfunduar.

Kështu që, në këtë kontekst unë shikoj që janë disa faktorë të cilët nuk janë të varur nga vullneti i gjyqtarit, e cila edhe natyrisht mund të ketë pasur dëshirën dhe e ka pasur dëshirën për t'i përfunduar ato. Këtu vlerësoj edhe qëndrimin subjektiv të gjyqtarit zakonisht në qasjen që ka ajo për të evaduar dosje gjyqësore dhe kam konstatuar që për shembull për vitin 2016, pavarësisht se në mars deri në dhjetor ajo ka qenë me leje lindje, që do të thotë në janar dhe shkurt ka qenë në fazë ndoshta edhe të rënduar shëndetësore, por pavarësisht nga kjo, gjyqtarja ka shpallur 88 vendime gjyqësore (të paktën kjo më del nga statistikat – Yllka edhe mund të ma konfirmojë), që tregon që vullneti dhe qasja e gjyqtarit në këtë aspekt ka qenë drejt faktit të një rendimenti të lartë, shpallje numrash vendimesh apo evadime dosjesh në mënyrë të shpejtë dhe normalisht për një muaj ka goxha vendime gjyqësore të shpallura.

Gjithsesi, për të parë qasjen e saj edhe më pas që nuk ka lidhje me burimin e vlerësimit në rastin konkret, por shikoj thjesht qëndrimin subjektiv të gjyqtarit në raportin që ka ajo me përmbushjen e detyrimit “shpalljen e detyrimeve gjyqësore”, aktualisht shikoj që gjyqtarja në këtë vit ka 480 dosje në dorë, nga të cilat ka përfunduar 344. Pra me çfarë shikoj kemi të bëjmë me një gjyqtare e cila ka një qasje pozitive në raport me përmbushjen e detyrimit të saj “shpalljen e vendimeve”, dhe zakonisht kam qenë kritik në ato gjykata të cilat kanë demonstruar apo kanë treguar aftësi rendimenti të ulët dhe natyrisht jam bashkuar me ju ose kam bërë protagonizëm për ta kritikuar këtë lloj qasje të gjyqtarëve, por që në rastin konkret konstatoj që me të vërtetë janë verifikuar faktorë të

tillë të cilët nuk kanë pasur lidhje me qëndrimin subjektiv të gjyqtarit apo me vullnetin e saj për të evaduar dosje të cilat i janë ngarkuar sepse dosjet kanë qenë të menjëhershme dhe ngarkesa natyrisht Fieri mbahet për ngarkesë jashtëzakonisht të madhe të dosjeve gjyqësore.

Kështu që në këtë aspekt unë kërkoj që t'i shtohen, propozoj, jo kërkoj, propozoj t'i shtohen 2 pikë.

Së dyti, duke marrë shkak edhe nga e-maili për të cilin u fol dhe u debatua apo korrespondenca që është mbajtur, unë propozoj që edhe në këtë aspekt, tek “Aftësitë personale dhe angazhimi profesion”, në nënkategorinë 4.C.c, duke parë që qëndrimi i gjyqtarës ka qenë pjesë e organizimit dhe lidhjes së ambasadës me stafin e trupës gjyqësore apo me përpjekjet që ajo ka bërë për të realizuar atë objektiv të cilin ambasada me trupën gjyqësore ka pasur, edhe ajo ka ndihmuar, kështu që edhe në këtë aspekt unë nuk shikoj ndonjë pengesë për t'i dhënë apo për t'i shtuar edhe 2 pikë në këtë kategori. Ky ishte propozimi. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Ka diskutime?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, marrë shkas edhe nga diskutimet që bëri gjyqtarja. Pa dyshim që gjyqtarja ka treguar, për sa i përket performancës së saj në tërësi, një performancë të mirë, sepse ne u kapëm vetëm me rendimentin, por referuar të gjithë projekteraportit të përgatitur nga relatorja mos harrojmë që edhe pse ka pasur një standard minimal të kaluar me 28% të afatit, ajo ka shkuar në pikëzim maksimal. Pra gjithmonë ka qenë tendenca e rritjes në nivel të pikëzimit sepse janë marrë parasysh elementë të cilët nuk lidhen me gjyqtaren personalisht. Për sa i përket rendimentit, dua të them dy favorizime që ka gjyqtarja në rastin konkret, “favorizime” për shkak të situatave të saj. E ka filluar punën me 0 çështje. Pra nëse gjyqtarit kur i llogaritet rendimenti në çështjet e caktuara i futen të gjithë çështjet që mund të ketë pasur, kjo e fillon me 0 dhe po kështu e përfundon me 0 sepse largohet me barrë lindje. Pra i lë çështjet. Dhe sidomos

që, numri i çështjeve që ajo ka zgjidhur është favorizues në këtë rast për gjyqtarin. Megjithatë, ne kemi dashur që, duke qenë se të dhënat statistikore janë gjithmonë të dhënat më objektive në vlerësimin e gjyqtarit, të evidentojmë vërtet atë gjyqtar që ka një normë shumë të madhe të likuidimit të çështjeve. Kemi parë gjyqtarë me 2000 çështje në vit dhe pikërisht janë këta gjyqtarë që e kanë kaluar jo vetëm më shumë se 50% por edhe mbi 100% dhe 200%, që janë vlerësuar maksimalisht. Pra duhet të ketë një marzh. Ne nuk mund të jemi subjektiv në maksimum. Pra ky diskrecion duhet të ketë një kufi për të evidentuar vërtetë gjyqtarin që evidenton një shkallë shumë të lartë likuidimi të çështjeve, sepse e kemi të pamundur që të shohim se sa komplekse janë të gjitha çështjet që shqyrton gjyqtari. Për këtë arsye mendoj që vlerësimi që relatorja ka bërë është objektiv dhe në përputhje me situatën personale të gjyqtares sepse është rritur me dy nivele në rendiment.

Ndërsa për i përket pretendimeve të gjyqtares për t'iu njohur edhe si veprimtari ndërinstucionale edhe si mentorim kontributi që ka dhënë ajo, në fakt ne kemi pasur edhe raste të tjera që nuk i kemi konsideruar veprimtari të tilla, sepse kemi vlerësuar që për të shmangur çdo subjektivizëm, duhet të provohet një kontribut efektiv i gjyqtarit, qoftë në mentorim, qoftë në veprimtari ndërinstucionale që ka pasur për qëllim përmirësimin e legjislacionit. Ka pasur gjyqtarë që kanë sjellë e-maile në kuadër të reformës në drejtësi, por nuk provohej kontributi efektiv, edhe pse mund të kishin shkuar në fakt.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka propozime dhe diskutime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime dhe propozime të tjera, fillimisht hedhim në votim propozimin e parë të zotit Toro në lidhje me rubrikën “Aftësia organizative e gjyqtares”, seksioni “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, zoti Toro propozon një vlerësim me 2 pikë të rritura, pra nga 8 pikë të vlerësohet me 10 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Pro.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Miratohet propozimi i zotit Toro.

Atëherë, hedhim në votim propozimin e dytë të zotit Toro, që ka të bëjë me rubrikën “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, konkretisht në rubrikën “Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndërinstytucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” ku zoti Toro propozon një shtesë prej 2 pikësh, pra nga vlerësimi me 3 pikë për këtë rubrikë, të bëhet në vlerësimin 5 pikë.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Illir Rusi: Kundër.

Atëherë miratohet propozimi i parë i zotit Toro dhe rrëzohet propozimi i dytë i zotit Toro.

Atëherë, hedhim në votim projektraportin përkatës në lidhje me zonjën {...}, duke u përfshirë edhe ndryshimet përkatëse në lidhje me votimin e propozimit të parë të bërë nga zoti Toro.

Irena Plaku: Pro, për sa kohë u votua nga shumica e anëtarëve.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarës {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës { ... }, për periudhën 2017 – 2019”, relatore znj. Irena Plaku.⁴

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 17:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Irena Plaku | (anëtare) |
| 4. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 5. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 6. Alban Toro | (anëtar) |
| 7. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 9. Yllka Rupa | (anëtare) |

⁴ Sipas rendit kjo çështje renditet nr. 9. Pika 5 e rendit shtyhet. Shih procesverbalin e pikës së parë.

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

5. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. {...}, gjyqtare.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017 – 2019”, relatore *znj. Irena Plaku*.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me trajtimin e një pike tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarës {...}, për periudhën 2017 – 2019”, për të cilin është përgatitur relacioni nga zonja Plaku. Gjithashtu zonja {...} ka bërë kërkesë për të qenë prezent në këtë mbledhje dhe është prezent, kështu që ftohet të marrë pjesë.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtarja znj. {...}.)

Ilir Rusi: Atëherë vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës. Prezent është zonja {...}. Kështu që fjala për relatoren zonjën Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Atëherë po ju parashtroj në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional për gjyqtaren {...}, për periudhën e vlerësimit 2017 – 2019. Duke qenë se me projektraportin analitik janë njohur të gjithë anëtarët, por edhe gjyqtarja, e cila ndër të tjera ka paraqitur edhe kundërshtimet përkatëse të cilat do relatohen prej saj duke qenë se është prezent.

Procedura e vlerësimit për gjyqtaren ka filluar me vendimin nr. 177 të datës 29.04.2021, ku me këtë vendim është përcaktuar edhe relatori edhe nëpunësja përgjegjëse, konkretisht ka qenë anëtarja {...}. Në kushtet kur kjo e fundit i ka mbaruar mandati, me vendimin e datës 17.01.2022 jam përcaktuar unë si relatore dhe nëpunëse përgjegjëse {...}.

Janë kryer të gjitha procedurat për administrimin e të gjitha burimeve të vlerësimit nga Shkolla e Magjistraturës, nga Inspektorati i Drejtësisë, nga ILDKPKI-ja si dhe dosjet të cilat janë hedhur me short, dhe janë administruar në këtë proces.

Në datë 08.05.2023 është përfunduar dhe është dorëzuar raporti analitik.

Me vendimin e datës 15.05.2023 është vendosur nga Komisioni plotësimi i procedurës dhe dokumentacionit dhe hartimi i projektraportit. Pas hartimit të projektraportit të vlerësimit është njoftuar gjyqtarja rregullisht e cila brenda afatit ka paraqitur edhe kundërshtimet e saj si dhe provat bashkangjitur të cilat i janë njoftuar të gjithë anëtarëve.

Vlerësimi etik dhe profesional përbëhet nga katër kriteret e vlerësimit.

Po filloj shkurtimisht tek kriteri i parë “Aftësia profesionale e gjyqtares”, konkretisht tek treguesi “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, nga burimet e vlerësimit ka rezultuar se gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analizës së fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe fakteve që lidhen me themelin e çështjes, duke i parashtruar ato në pjesën e parë që është “Procedura” dhe në pjesën e dytë që është “Rrethanat e faktit” apo “Faktet dhe provat”. Gjyqtarja përcakton qartë natyrën e çështjes, si në mënyrë të shprehur ashtu edhe të nënkuptuar. Çështjet përcaktohen që në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, referuar specifikave të tij. Citon dhe analizon ligjin procedural në zgjidhjen e çështjes ashtu edhe ligjin material në

zbatimin e çështjes. Në projektraport janë cituar të gjithë dispozitat të cilat janë cituar nga ana e gjyqtares në vendimmarrje, jo vetëm dispozita të kodeve përkatëse por edhe të ligjeve të veçanta kur ato kanë qenë të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjithashtu ka cituar edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, etj.

Në tërësi është arritur në konkluzionin që gjyqtarja shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së plotë të fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së çështjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim. Në rastet kur ka qenë thelbësore për zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja ka vendosur përballë njëra tjetrës, në plan krahasimor, dispozitat materiale, për të konkluduar mbi kualifikimin ligjor të faktit, kryesisht në çështjet penale.

Pas analizimit të të dhënave vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi identifikimi i normës juridike (procedurale dhe materiale) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja. Normat ligjore me natyrë procedurale apo materiale, citohen dhe referohen, duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Gjyqtarja i kushton vëmendje interpretimit të normave në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin e çështjes. Gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin teleologjik, duke identifikuar qëllimin e normës, por edhe interpretimin literal dhe sistematik të normave, duke përqasur kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara.

Në projektraport janë cituar të gjitha normat të cilat interpretohen nga ana e

gjqtares, si atyre me natyrë materiale ashtu edhe dispozitave procedurale. Gjithashtu evidentohet aftësia e gjyqtares në identifikimin duke përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante të vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimin e Kolegjit Civil, Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së në mbështetje të argumenteve të saj.

Gjithashtu rezulton kujdesi i gjyqtares gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, të referojë dhe zbatojë parimet e përgjithshme të së drejtës.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter civil apo penal. Evidentohet një kujdes shumë i lartë i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor.

Sa më sipër vlerësoj se aftësia e gjyqtares për këtë tregues është shumë e lartë dhe për këtë arsye gjyqtarja duhet të pikëzohet me 25 pikë.

Sa i përket treguesit “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale dhe dosjet e analizuara në komunikim shkresor me të tretët dhe vendimi gjyqësor është i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm. Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në thonjëza), duke u shoqëruar me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse, pa krijuar konfuzion.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i

të gjitha shkronjave të gjuhës shqipe. Përdor shenjat e pikësimit, thonjëzat, etj.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Të gjitha vendimet janë organizuar në nënndarje, të identifikuara me tituj dhe me paragrafë të numërtuar duke orientuar qartë përmbajtjen e tyre, të cilët lidhen me njëri-tjetrin në mënyrë kronologjike dhe vazhdimësisë së mendimit.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë dhe duhet pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Struktura e qëndrueshme dhe e organizuar e vendimit”, nga burimet e vlerësimit rezulton se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikëpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale apo të themelit të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Këto të fundit vijnë gjithnjë si mbyllje e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ndjek përgjithësisht një metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuara me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë dhe në të gjitha rastet. Këto pjesë janë të ndara në paragrafë, të cilat e lehtësojnë shumë të kuptuarit e vendimit duke mundësuar referimin në paragrafët e mësipërm. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese, si dhe dispozitivin.

Në projektraport janë përshkruar në mënyrë të detajuar se çfarë përmban secila nga këto pjesë të vendimit, të cilat, ndër të tjera, siç e thashë janë të ndara në nëntituj.

Në tërësi, në konkluzion evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, të ndarë në tituj dhe gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë. Ka një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjyqimit apo të vlerësuara kryesisht, parashtrimi i rrethanave

të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë pjesë e rrethanave të faktit, ligjin e zbatueshëm, trajtimin e çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë. Konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi të vendimit janë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket treguesit “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, janë analizuar të gjitha burimet e vlerësimit, vendimet të cilat janë burim vlerësimi. Në tërësi, në konkluzion, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, duke i vlerësuar tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, komplekse ose jo, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në këtë tregues. Konstatohet së vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në varësit të kompleksitetit të çështjes dhe pretendimet e palëve, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumenta të lidhura me njëri-tjetrin, duke i ndalur tek evidentimi i lidhjes shkak-pasojë në raport me konkluzionet për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja i kushton rëndësi analizimit të pretendimeve të palëve në raport me rrethanat konkrete, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjet e procedurës ashtu dhe ato për themelin e çështjes. Përgjithësisht, arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Pas analizës së të dhënave, vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Propozimi për kriterin e parë është 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit të dytë “Aftësia organizative e gjyqtarës”, konkretisht tek treguesi “Respektimi i afateve ligjore”, sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 410 çështje për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, 104 prej tyre janë pasqyruar në tejkalim të afatit ndërsa 306 janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit,

rezulton që gjyqtarja të ketë gjykuar 25.3 % të çështjeve jashtë afatit.

Janë bërë edhe një herë ripunimi i të dhënave statistikore nga ana e relatorit. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afateve (kanë rezultuar 98 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (kanë rezultuar 408 çështje), gjyqtarja rezulton të ketë gjykuar 24 % të çështjeve jashtë afatit.

Më pas, për përlogaritjen e këtyre të dhënave janë zbritur edhe koha gjatë së cilës gjyqtarja ka kryer lejen e zakonshme si dhe festat e fundvitit, duke bërë një analizë të detajuar të çështjeve të cilat vlerësohen se mund të zbriten nga numri i përgjithshëm.

Konkretisht, duke iu referuar tabelës me të dhëna statistikore të çështjeve të analizuara më sipër, rezulton se numri i çështjeve me afat ligjor është 408. Po ashtu në numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (98), duhet të zbriten 19 çështje, pasi referuar analizës së tyre, rezulton se ato duhet të konsiderohen të përfunduara brenda afatit. Pas një analize të tillë ka rezultuar se 19.3 % e tyre janë gjykuar jashtë afatit, që sipas metodologjisë së pikëzimit, pikëzohet me 12 pikë.

Referuar metodologjisë së pikëzimit lidhur me këtë tregues, ku është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, referuar kompleksitetit të çështjeve, ngarkesën e gjyqtarit, rritjen e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin e volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjatë periudhës 3-vjeçare ka përfunduar 1588 çështje, nga të cilat 408 çështje parashikojnë afat ligjor dhe 632 çështje me palë kundërshtare, pra mesatarisht ka gjykuar rreth 530 çështje në vit, pa përfshirë këtu ngarkesën si anëtare e trupit gjykues. Për sa më sipër, duke qenë se gjyqtarja ka realizuar standardin sasior, është propozuar rritja e pikëzimit të tij me një nivel, duke e rritur në pikëzimin maksimal prej 15 pikësh.

Për sa i përket “Plotësimit të standardeve minimale kohore”, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej rreth 1180 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 1178 çështje

të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 235 prej tyre apo 19.94 % janë gjykuar tej standardit minimal.

Është bërë edhe një përlllogaritje tjetër nga ku ka rezultuar se rreth 20% e çështjeve janë shqyrtuar tej standardit kohor minimal.

Edhe për këtë tregues janë pasur parasysh pretendimet e gjyqtarës të cilat janë pasqyruar në vetëvlerësimin e gjyqtarës. Janë zbritur disa të dhëna, konkretisht janë zbritur disa afate, nga afati i gjykimit të çështjeve, konkretisht leja vjetore, festat e fundvitit dhe afati mbartjes së dosjeve, nga ku, pas një rillogaritje të këtyre afateve ka rezultuar se prej 233 çështje të përlllogaritura në raportin analitik të cilat ishin gjykuar jashtë standardit minimal do zbriten edhe 67 çështje nga të cilat kështu rezulton se çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal janë 166 çështje. Pra rezulton se përqindja e çështjeve, raporti midis çështjeve për të cilat parashikohet standard minimal dhe atyre të shqyrtuara tej këtij standardi rezulton tashmë 14%, e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 4 pikë.

Edhe në këtë rast, referuar metodologjisë së pikëzimit, në përcaktimin e nivelit të vlerësimit, të dhënat statistikore analizohen duke shmangur çështjet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Konkretisht në këtë rast është marrë parasysh ngarkesa e gjyqtarës e cila ka gjykuar 1588 çështje nga të cilat 632 çështje kanë qenë me afat ligjor; faktin që çdo vit gjyqtarja e ka tejkuluar standardin minimal sasior me 101%.

Referuar sa më sipër është propozuar rritja e pikëzimit për këtë tregues me një nivel duke arritur në nivelin maksimal prej 5 pikësh.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje”, referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik ka rezultuar se koha minimale që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se shumicën e kategorive të çështjeve (4 nga 6 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorive “Penale-kundërvajtje” dhe “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak ku

standardi minimal është tejkeluar me 4 dhe 12 ditë, çka vlerësohet tejkalim i papërfillshëm, gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 5 pikë.

Sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve”, referuar burimeve të vlerësimit, raportit analitik, na rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, gjatë periudhës së vlerësimit ka rezultuar me 96.7 %. Në vitin 2017 ka rezultuar përkatësisht 83.5%. Në vitin 2018, 97.9% dhe në vitin 2019, 107%.

Sipas metodologjisë së vlerësimit kjo përqindje pikëzohet me 8 pikë.

Duke iu referuar faktit të ngarkesës së gjyqtarës dhe faktin se gjyqtarja ka tejkeluar standardin minimal mbi 50% të ngarkesës minimale sasiore të përcaktuar në aneksin 1 të sistemit të vlerësimit, është propozuar pikëzimi i saj me rritjen e një niveli, duke arritur në pikëzimin maksimal prej 10 pikësh.

Pra për këtë tregues, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që përkon me rendimentin në masën +99%, duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimit” – referuar burimeve të vlerësimit, ka rezultuar se koha mesatare është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, që i korrespondon pikëzimit me 15 pikë.

Sa më sipër, për këtë tregues, duke qenë se afati i arsyetimit të vendimit është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, propozohet pikëzimi i saj me 15 pikë.

“Aftësia e gjyqtarës për të kryer procedurat gjyqësore”.

Në analizën e të dhënave, për treguesin “numri mesatar i seancave”, numri i seancave ka rezultuar 4.9 seanca, por pavarësisht numrit të lartë, gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproductive për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave. Shkalla e aftësisë së saj duhet të vlerësohet dhe pikëzohet me 15 pikë.

Sa i përket “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale në organizimin e procesit”, në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën, duke treguar kujdes

maksimal për marrjen e masave për njoftimin e palëve, etj. Janë respektuar të gjitha rregullat e parashikuara në kodet përkatëse.

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë dhe duke respektuar të drejtat e palëve.

Sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues rezulton shumë e lartë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Sa i përket treguesit “Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen”, konkretisht “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes”, nga analiza e burimeve të vlerësimit në raportin analitik rezulton se aktet e dosjes janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë dhe renditje. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur renditjen e akteve në dosje, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në këtë kuptim përgjithësisht renditja ka filluar me aktet që kanë vënë në lëvizje gjykatën, aktet e paraqitura nga palët para fillimit të seancave, veprimet dhe vendimmarrjet e gjykatës gjatë veprimeve paraprake, nëse ka. Më pas kalohet tek procesverbalet, parashtrimet e palëve, gjithmonë sipas datës së zhvillimit të seancës.

Në rastin konkret renditja sipas llojit të akteve procedurale por e ndërthurur kjo edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën lehtësisht të aksesueshme dosjen.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se lidhur me këtë tregues, aftësia e gjyqtarës është shumë e lartë për shkak se gjyqtarja ndjek në renditjen e dosjes e cila është përgjithësisht e njëjtë, ndjek rendin logjik dhe kronologjik brenda së njëjtës kategori, është bërë në mënyrë të tillë që të bëjë dosjen lehtësisht të aksesueshme.

Sa i përket treguesit “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit”, nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, përfshihen vetëm dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit deri në dhënien e

vendimit përfundimtar.

Në dosjet penale nuk rezulton të jetë administruara kopje e “Letrës së të drejtave”, e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, ndërkohë që nga komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a , 58 , 140 paragrafi 1 dhe 137 i K.Pr.Penale. Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga këto nene janë garantuar, duke iu bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mos administrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosje, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit.

Në konkluzion, referuar sa më sipër, duke qenë se kemi këtë mungesë, pasur parasysh edhe standardet e mbajtura nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor në vlerësimin e gjyqtarëve të tjerë është propozuar aftësia e saj mbi mesatare duke e pikëzuar me 8 pikë, për sa kohë që ka rezultuar mungesë e administrimit të kopjes së “Letrës së të drejtave”, që siç e përcaktuam më sipër, siç përcaktohet në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, është e detyrueshme t’i njoftohet palëve ndërgjyqëse, konkretisht të pandehurit, viktimat, etj.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për sa i përket treguesit “Aftësia organizative” është 98 pikë. Niveli i vlerësimit është "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”, konkretisht “Etika në punë”, “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”, referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për sa më sipër vlerësohet aftësia e saj shumë e lartë, duke e pikëzuar me 35 pikë.

Sa i përket treguesit “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, lidhur me këtë tregues, janë administruar të dhënat nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, ashtu edhe nga ILDKPKI-ja, nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna që mund të afektojnë këtë tregues. Për këtë arsye aftësia e saj është vlerësuar shumë e lartë dhe propozohet pikëzimi me 40 pikë.

“Paanësia e gjyqtarit”, treguesi “Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese”, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në

asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit dhe në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Referuar sa më sipër vlerësoj se aftësia e saj është shumë e lartë dhe duhet të pikëzohet me 10 pikë.

Sa i përket treguesit “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtarës i janë paraqitur 5 kërkesa për përjashtimin e subjekteve, të cilat janë rrëzuar, ndërkohë që vetë subjekti ka paraqitur 60 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 45 janë pranuar. Referuar sa më sipër është vlerësuar se numri duhet të konsiderohet i pakonsiderueshëm dhe për këtë arsye propozohet pikëzimi i saj me 15 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Etik dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, është 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Sa i përket kriterit “Aftësia personale dhe angazhimi profesional”, “Aftësia e komunikimit”, “Komunikimi i qartë dhe transparent”, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparent me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme. Për këtë arsye vlerësohet se aftësia e saj është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, nga analiza e burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtarja ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, konkretisht “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët”, edhe për këtë tregues është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë, pasi rezulton se shkalla e komunikimit është shumë e lartë.

Edhe për sa i përket treguesit tjetër, konkretisht “Shkalla e bashkëpunimit me administratën gjyqësore”, rezulton shumë e lartë.

“Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, konkretisht “Pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitete të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”. Nga burimet e vlerësimit, konkretisht rezulton se në cilësinë e pjesëmarrëses gjyqtarja ka marrë pjesë në 28 aktivitete trajnuese të

zhvilluara në periudhën e vlerësimit, gjithsej e shpërndarë në 37.5 ditë trajnimi. Ndërsa në cilësinë e lehtësueses në programin e formimit vazhdues ka marrë pjesë në 4 aktivitete trajnuese të zhvilluara në periudhën e vlerësimit, në 7 ditë, që konvertohen në 14 ditë trajnimi si pjesëmarrëse.

Referuar sa më sipër, duke qenë se numri i ditëve të pjesëmarrjes së saj është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë, është propozuar pikëzimi i saj me 20 pikë.

Sa i përket treguesit “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional”, siç e theksuam më sipër, gjyqtarja ka marrë pjesë, është angazhuar në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës konkretisht në 5 aktivitete trajnuese të zhvilluara gjatë periudhës së vlerësimit, e shtrirë në 7 ditë trajnimi.

Referuar metodologjisë së pikëzimit për këtë tregues, e cila për çdo gjyqtar nis me 3 pikë dhe në rast të vërtetimit të angazhimit të gjyqtares rritet me 2 pikë, për gjyqtaren propozohet pikëzimi i saj me 5 pikë, për sa kohë rezulton pjesëmarrja e saj në aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses.

Për sa i përket treguesit “Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë”, nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se për gjyqtaren nuk ka të dhëna për këtë tregues.

Për këtë arsye, referuar metodologjisë së pikëzimit që përcakton që për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në vullnetin e gjyqtares (e fillon me 3 pikë) dhe 2 pikë i shtohen në rast të vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari. Vlerësoj se për gjyqtaren ky tregues do të pikëzohet me 3 pikë, për sa kohë nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj.

Sa i përket treguesit “Publikime ligjore”, edhe për këtë tregues nuk rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtarja të ketë publikime ligjore. Për këto arsye është propozuar pikëzimi i saj me 0 pikë.

Gjyqtarja në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar se ka bërë një artikull, konkretisht “Instituti i gjësë së gjykuar”, e cili është publikuar në vitin 2011, gjatë kohës që në fakt gjyqtarja ka qenë në cilësinë e magjistrates dhe kryerjes së Shkollës së

Magjistraturës, duke qenë se kjo nuk i përket periudhës së vlerësimit, siç i qëndroj propozimit prej 0 pikësh.

Propozimi për kriterin e katërt “Aftësia profesionale dhe angazhimi profesional” është 93 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter është si më poshtë:

100 pikë kriteri i parë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm";

Kriteri i dytë “Aftësia organizative e gjyqtarës”, 98 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Kriteri i tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Kriteri i katërt “Aftësia profesionale dhe angazhimi profesional”, 93 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Propozimi për nivelin e përgjithshëm është 390 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Në përfundim të raportit janë bërë edhe rekomandimet përkatëse.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Irena Plaku: Nuk përmenda kundërshtimet, për sa kohë është vetë gjyqtarja dhe mund t'i relatojë në mënyrë të përmbledhur për sa kohë të gjithë anëtarët janë njohur me kundërshtimet.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Atëherë, fjala për ju zonja {...}, për të paraqitur kundërshtimet sipas rubrikave/seksioneve përkatëse.

{...}: Do përpiqem të jem në mënyrë të përmbledhur.

Lidhur me kriterin 2.C.b. “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është evidentuar mungesa e “Letrës së të drejtave” në projektraport, konstatoj se letra e të drejtave është futur si risi në dispozita të caktuara të Kodit të Procedurës Penale. Dua të

falenderoj relatoren sepse e ka evidentuar faktin që në të gjitha proceset gjyqësore ose dosjet që janë mbajtur parasysh për vlerësim, unë si gjyqtare ua kam sjellë në vëmendje palëve (të pandehur ose viktimë) të drejtën në rastin konkret, kur i takonte, për t'u njohur me të drejtën duke ia shpjeguar dhe duke mos i sjellë pasoja ligjore. Kështu që, kjo është pika e parë thelbësore që sjell këtë si kundërshtim.

E dyta është fakti që letra e të drejtave iu komunikohet të pandehurve ose të arrestuarve, që në komisarjat, iu komunikohet nga prokurori, letra e të drejtave dhe viktimës, dhe dosja e prokurorit bëhet pjesë e fashikullit të gjykimit. Normalisht edhe në këtë aspekt duhet të shihet që nuk duhet parë si problem i dosjes së gjyqtarit. Si praktikë gjyqësore normalisht në gjykatën ku unë punoj, gjithë njoftimet i bën sekretaria gjyqësore dhe nis edhe letrën e të drejtave dhe ndoshta nuk është administruar në dosje por që të pandehurve, viktimave të çështjes, iu është vënë në dispozicion.

Gjithashtu doja të theksoja, se ndoshta e kam shtjelluar në shpjegim që mungesa e një letre të tillë fizike nuk ka sjellë asnjë pasojë për çështjet që janë objekt vlerësimi por as për çështjet e tjera nuk ka sjellë pasoja, as në Gjykatën e Apelit për këto dosje.

Ndërsa për kriterin 4.C.c. “Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndërinstytucionale”, në kuadër të trajnimit që është zhvilluar në Hagë, në “Matra Rul of Low Training”, ku ka qenë administrimi i drejtësisë edhe ka qenë një trajnim dyjavor ku fokusi ishte të trajnoheshin gjyqtarët kryesisht të vendeve të lindjes për mënyrën se si duhet të administrohej drejtësia edhe gjykatat, edhe në fund të saj projekti ishte që ti duhej të zgjidhje një tematikë të caktuar që kishte nevojë për t'u zhvilluar dhe për t'u trajtuar në vendin nga ne vinim dhe ne si grup ishim tre gjyqtarë nga Shqipëria, zgjodhëm gjyqtarin e medias duke parë që në Shqipëri ishin në hapat e parë disa projekte për t'u zhvilluar më pas si koncepte dhe për t'u elaboruar më tej. Zgjodhëm këtë si projekt dhe na u la si detyrë shtëpie ose “back home action plan”, sepse do takoheshim më pas në Shkup të Maqedonisë së Veriut ku do të prezantonim përpara të gjithë grupeve që merrnin pjesë ose që kishin ndjekur këto aktivitete trajnuese në Hagë, ku ne do të prezantonim, do të bënim një “research” për situatën në Shqipëri, si ishte situata në gjykatat nga ne vinim, si ne sugjeronim të zgjidhej situata, dhe këtë do ta referonim përpara të gjithë auditorit që merrte pjesë në Shkup, ku do merrnin “feedback”-un,

sikundër morëm nga të gjithë shtetet pjesëmarrëse që ishin gjyqtarë, ishin administratë gjyqësore (nuk ishin vetëm ata të atij projekti), dhe ishin një numër i madh pjesëmarrësish. Unë këtë e kam dokumentuar nëpërmjet e-maileve që kemi mbajtur me organizatorët: programin që ata kanë nisur, numrin e pjesëmarrësve që ata kanë nisur, kam korrespondencën me dy anëtarët që kanë qenë pjesë e trajnimit, që janë gjyqtarë shqiptarë, dhe kam dokumentuar edhe me punimin që ne kemi bërë, prezantimin që kemi bërë në atë trajnim. Duke qenë se kërkohet që ti të bësh një referim në auditor, që nuk është auditor gjyqtarësh shqiptarë, por ka qenë një trajnim në kuadër të një shkëmbimi eksperiencash të gjyqtarëve midis vendeve.

Kështu që në këtë kriter, mendoj se duhet të vlerësohem maksimalisht, pra të shtohen edhe 2 pikë të tjera, duke qenë se jam vlerësuar me 3 pikë. Mendoj që duke qenë se ka qenë një punë që unë e kam kryer si gjyqtare jashtë profesionit, kam kryer një punë kërkimore për çështjen, mendoj se duhet të vlerësohem të paktën, duke qenë se kam dokumentacion për këtë pikë.

Ndërkohë që lidhur me kriterin 4.C.c. (4.C.ç.) që është “Publikime ligjore akademike”, sikundër e përmendi edhe relatorja, unë i jam referuar një publikimi që kam bërë në vitin 2011, pasi metodologjia kërkon një botim në një revistë me ISBN ose me standarde. Atë botim në vitin 2018, duke qenë se kam qenë në cilësinë e lehtësueses në Shkollën e Magjistraturës dhe nga dy ekspertet (sikur e kam dokumentuar edhe me e-maile), më është caktuar (duke qenë se ishin në dijeni që unë kisha një botim për atë çështje), më është thënë që shiko, në një pjesë të caktuar të trajnimit mund të bësh ti një referim për gjyqtarët, domethënë të japësh trajnim për gjyqtarët, dhe kam paraqitur të gjithë korrespondencën me ekspertët, materialin që unë kam nisur tek Shkolla dhe ndërkohë kontrata që ne lidhim me Shkollën sot si lehtësues, për të gjithë artikujt që ne nisim, punimet, punën që ne kemi bërë, ne japim aprovimin që materiali të publikohet. Unë e kam paraqitur materialin që unë e kam prezantuar në atë trajnim, sepse kështu mund të quhet, e kam riprezantuar, e kam ripunuar, dhe e kam prezantuar në atë trajnim. Unë kërkoj që nëse pikëzimi në atë kriter është nga 1 tek 5 dhe mua më mungon forma, sepse nuk e kam publikuar me ISBN në 2018, por ndërkohë unë e kam bërë si punim, e kam sjellë si ripunim, është një punë që unë e kam kryer, unë kërkoj të vlerësohet ose të

pikëzohet. Për sa kohë metodologjia thotë nga 1-5 dhe është një punë që unë si gjyqtare e kam bërë (se është një punë që unë e kam bërë realisht), i kërkoj Këshillit ta pikëzoj, qoftë edhe për të motivuar gjyqtarët e tjerë që mos të jemi kaq strikt, duke qenë se ka pikëzim.

Këto ishin kundërshtimet. Në qoftë se do kishte pyetje, mund t'jua sqaroj. Unë i kam shpjeguar dhe ndoshta është ora edhe vonë dhe nuk dua t'ju zgjas dhe t'ju lodh me shpjegime. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Ka ndonjë pyetje nga anëtarët?

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Një pyetje lidhur me letrën e të drejtave, sepse u ngacmova nga kjo pjesa. Zakonisht letra e të drejtave jepet në momentin e pyetjes për herë të parë që i bëhet të pandehurit ose kur ai është i arrestuar apo i ndaluar, apo jo? Në mos gabohem. Në shpjegime thatë që i kemi dërguar letrën e të drejtave me njoftim nëpërmjet sekretarisë gjyqësore, etj., etj.

Jemi tek procesi i të arrestuarit dhe të ndaluarit. Kur jeni gjyqtare që për herë të parë duhet të shqyrtoni një kërkesë për caktimin e masës dhe vlerësimin e arrestit, apo jo. Tani, në këtë pikë, ku i pandehuri është në sallë, juve ia keni dërguar letrën e të drejtave me sekretare gjyqësore (thoni në këto shpjegime)?

(Gjyqtarja përgjigjet pa ndezur mikrofonin.)

Klodian Kurushi: Ia ke dhënë kundrejt nënshkrimit apo jo? Se ligji këtë thotë, apo jo?

{...}: Konstatonim që është njoftuar në komisarjat se ata e kishin formalizuar fillimisht si letër të drejtash dhe nëse e kishte marrë prokurori në pyetje (tek masat e sigurimit po flasim), ia kishte njoftuar prokurori, dhe unë si gjyqtare konstatoja që atij i

ishte respektuar formalisht e drejta. Ai mund të mos kishte kuptuar fare çfarë thuheshin aty dhe në momentin procedural që unë duhet t'i njoftoja një të drejtë (prandaj thashë e vlerësoj relatorin se e ka evidentuar këtë fakt), unë ia kam komunikuar edhe ia kam sqaruar që ty të takon kjo; unë po ta shpjegoj si gjyqtare; të takon ty pastaj të shfaqësh vullnetin. Dhe ia kam shpjeguar edhe në terma që ndoshta nuk janë aq ligjorë, që ai ta kuptonte se çfarë duhet të bënte në atë moment.

Klodian Kurushi: Ju thoni që është e mjaftueshme që nëse prokurori i njofton letrat e të drejtave në momentin e arrestimit të tij, gjyqtari që cakton masën e sigurimit dhe vlerëson arrestin, nuk është e nevojshme që t'i njoftojë letrën e të drejtave, si organ procedues po themi.

{...}: Efekt procedural të prishjes së vendimit nuk sjell.

Klodian Kurushi: E lëmë, se s'po hyjmë tek efektet procedurale.

{...}: Unë mund t'ia rinjoftoj.

Klodian Kurushi: Domethënë është në diskrecionin e gjykatës që mundet apo jo?

{...}: Jo, jo, gjykata duhet t'ia njoftojë. Nuk po them "mundet".

Po, po, gjykata duhet t'ia njoftojë. Nuk është dokumentuar në dosje sepse thashë ka ndryshuar në ato momente ka ndryshuar Kodi. Unë po flas për praktikën që ka qenë në Gjykatën e Fierit, që në Gjykatën e Fierit ne i thoshim sekretares shko jepja pak këtë letrën e të drejtave të pandehurit dhe ndërkohë ia thoshim që gjykata bëri me dije, dhe kjo ka qenë situata.

Klodian Kurushi: Pra me çfarë kuptova unë, faji është i sekretareve këtu apo jo?

{...}: Jo, nuk është faji i sekretareve.

Letrën ia kanë dhënë, por ne duhet t'i marrim firmën, po.

Klodian Kurushi: Kush duhet t'ia marri firmën?

{...}: Sekretari.

Klodian Kurushi: Sekretari!

Mirë! Faleminderit!

{...}: Normalisht nuk ka kontakt me gjyqtarit që unë të shkoj t'i jap letrën e t'i them ma firmos këtu.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime, pyetje?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime e pyetje, ftoj zonjën {...} të largohet me qëllim që Këshilli të vazhdojë me diskutimet përkatëse.

Faleminderit për prezencën zonja {...}.

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtarja znj. {...}.)

Ilir Rusi: Ftoj anëtarët.

Irena Plaku: E kam unë meqenëse...

Ilir Rusi: Po, patjetër, patjetër!

Fjala për relatoren znj. Plaku!

Irena Plaku: Atëherë, për sa i përket kundërshtimeve të paraqitura nga ana e gjyqtares, unë i qëndroj të njëjtave propozime, pasi për sa i përket letrave të së drejtave

ne kemi mbajtur një qëndrim. Justifikimi i gjyqtares që i dërgohet nga sekretaria nuk qëndron për shkak se përgjegjësia për njoftimin mbetet e gjyqtarit, është ajo që kontrollon njoftimet. Gjithashtu edhe justifikimi që nuk administrohet në dosje, në fakt tek shënimet, të paktën siç kemi ndjekur tek çështjet civile por edhe tek penalet, bëhej shënimi përkatës që bashkangjitur me këtë është letra e të drejtave. Gjithashtu unë kam edhe shembuj nga vlerësimet e tjera, që gjyqtari, në aktin e njoftimit ia bënte të ditura parashikimet ligjore dhe nuk e kanë të gjithë këtë mungesë (letrat e të drejtave). Domethënë ka gjyqtarë të cilët e respektojnë këto detyrime të përcaktuara në ligj, duke ia vënë në dije me njoftimin përkatës subjekteve të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Por siç e thamë, ne e kemi mbajtur një qëndrim në këtë rast dhe për sa kohë është provuar mungesa e letrave të të drejtave dhe nuk verifikohet në asnjë akt që të ndodhet në dosje, i qëndroj propozimit me 8 pikë.

Për sa i përket “Disponueshmëria e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale”, referuar edhe të gjitha qëndrimeve të mbajtura tashmë nga ana e Këshillit në vlerësimet e mëparshme, për të cilat kemi pasur edhe për anëtarë të Gjykatës së Lartë, ne nuk e kemi bërë pikëzimin për sa kohë nuk provohej kontributi drejtpërdrejt i gjyqtares, pasi pjesëmarrja në veprimtari/seminare të tjera është vlerësuar tek treguesi tjetër që ka lidhje me pjesëmarrjen e gjyqtares në trajnimin vazhdues si pranë Shkollës së Magjistraturës apo institucione të tjera dhe nuk mund të pikëzohet në një tregues tjetër, pasi në atë tregues, referuar rregullores janë përcaktuar rregullat se kush konsiderohet kontribut i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale.

Për sa i përket publikimit, referuar përsëri qëndrimeve, vetë metodologjia parashikon që botimi duhet të jetë në atë periudhë vlerësimi dhe duhet të jetë në revista shkencore, duhet të jetë me ISBN apo ISSN. Kemi pasur edhe publikime të tjera të cilat nuk e kanë pasur këtë ISBN dhe nuk janë vlerësuar por janë vlerësuar me 0 pikë nga ana e Këshillit. Në këtë rast publikimi nuk është bërë fare, por gjyqtarja ka dhënë kontributin si lehtësuese pranë Shkollës së Magjistraturës duke paraqitur një material që e kanë për detyrë ta paraqesin të gjithë lehtësuesit kur shkojnë pranë Shkollës së Magjistraturës, bëjnë edhe verifikimin e praktikave, sepse ai është roli në fakt i vlerësuesit. Dhe për këtë kontribut gjyqtarja është pikëzuar nga 3 pikë në 5 pikë. Kështu që unë i qëndroj

propozimit për të gjithë treguesit për të cilët gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Ka diskutime?

Alban Toro: Po, kam unë.

Ilir Rusi: Po, zoti Toro!

Atëherë, në kundërshtim me relatoren unë e shikoj ndryshe, në mënyrë më pozitive faktin që gjyqtarja në fjalë ka marrë në drejtimin dhe organizimin e një institucioni ndërkombëtar, të bëjë një vlerësim të çështjeve të lidhjes midis medias dhe gjykatave dhe bashkë me grupin e punës kanë dhënë një kontribut dhe këtë unë e nxjerr edhe nga informacioni që jep nëpërmjet e-maileve. Pra ne po kërkojmë tani informacione dhe dokumentim të disa periudhave të mëparshme dhe i vendosim gjyqtarit një pozicion që edhe për efekt kohe nuk kanë ndoshta t'i identifikojnë apo t'i gjejnë. Por aktualisht, korrespondenca tregon që paska pasur një “back home action plan” që në rastin konkret ka rezultuar të ishte i fokusuar nga këta gjyqtarë për çështje të lidhjes midis medias dhe gjykatave dhe më pas kanë përcaktuar organizatorët e këtij takimi edhe një minimum se sa i duhet secilit nga përfaqësuesit e shteteve (pra kanë përcaktuar një minimum prej 10 minutash për secilin vend) për të shtjelluar përmbajtjen e një materiali që në rastin konkret ka qenë një platformë apo një rregullim i medias, marrëdhënie midis medias dhe gjyqtarëve. Aktualisht të njëjtën punë bën edhe përfaqësuesja jonë e vetme duke drejtuar ndoshta edhe një grup tjetër për të përmirësuar këto akte nënligjore që kanë lidhje me gjykatë-media. Kështu që në këtë aspekt, unë mendoj që ose sugjeroj t'i japim edhe 2 pikë në këtë pjesë, pra në kriterin 4.C.c. “Angazhimi i gjyqtarës në veprimtari ndër-institucionale”.

Kalojmë tek pjesa, se këto ishin ato dy që të paktën mua mu dukën që edhe mund të reagojmë për të përmirësuar vlerësimin, “Publikimet ligjore akademike”, pra siç tha gjyqtarja, ka pas publikuar më parë një temë që është gjykimi gjë e gjykuar, të cilën më pas e ka ritrajtuar në magjistraturë. Në momentin që e trajton në magjistraturë, me anë të

kontratës individuale, i ka kaluar tagrat dhe të drejtën e publikimit të këtij materiali, të cilin unë prezumoj që Shkolla e ka publikuar sepse aktualisht të drejtat e publikimit i kanë kaluar Shkollës, dhe besoj se i kanë shërbyer Shkollës për të përmirësuar edhe praktikën e saj në lidhje me këtë materie tek trupa e ardhshme gjyqësore që do të integrohet në gjykatë. Kështu që unë jam edhe për pikën 4.C.ç të merret në konsideratë edhe ky publikim që ajo ka bërë pranë Shkollës së Magjistraturës, nëse është materializuar apo është bërë efektiv i takon Shkollës, të tretat e të cilës i kanë kaluar me nënshkrimin e kontratës përkatëse. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Toro!

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Lidhur me mungesën e letrës së të drejtave, doja të theksoja që në këtë rast gjyqtarja nuk është vlerësuar maksimalisht për aktet e administruara në dosje, jo për kryerjen apo jo të veprimit procedural. Pra një nga indikatorët e vlerësimit të “Aftësive organizative” është saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes. Mungon pikërisht letra e të drejtave, e cila duhet të jetë pjesë bashkëngjitur njoftimit që i bëhet të pandehurit.

Së dyti, për sa i përket veprimtarive ndërinstucionale. Tani unë këtu dua të ndalem, në trajnime dhe veprimtari ndërinstucionale. Trajnimet që gjyqtarët zhvillojnë mund të jenë trajnime dyditore afatshkurtra, afatmesme apo afatgjata, i kemi përcaktuar në metodologji. Këto trajnime mund të jenë pasive dhe interaktive, pra trajnime ku gjyqtari shkon dhe merr informacion por edhe trajnime ose ndryshe “workshop”-e ku gjyqtari ndërvepron interaktivisht për trajnim dhe në këto trajnime (se kemi marrë pjesë edhe vetë nëpër trajnime të tilla të gjithë ne) ngarkohet me kryerjen e një detyre, prezantimin e legjislacionit që ti ke në Shqipëri. Këto janë trajnime informuese, me qëllim për të marrë praktikën më të mira të vendeve. Por kryerja e veprimeve që tregojnë gatishmëri për përmirësimin e legjislacionit apo veprimtari ndërinstucionale me kontribut efektiv, kjo nuk përbën në vlerësimin tim.

Lidhur me botimin, ne vlerësojmë botimet, jo tentativat për botime. Botimi i është vlerësuar një herë gjyqtarës kur ajo ka qenë studente e Shkollës së Magjistraturës. Sjell në vëmendje se sipas rregullores së Shkollës, gjyqtarët që kishin botime në revistat juridike të kohës, gjithmonë merrnin pikëzime më të lartë. Ribotimi tani, nuk ka ndodhur, e para, dhe e dyta, materialet që ekspertët dhe lehtësuesit bëjnë për gjyqtarët që i nënshtrohen trajnimit vazhdues, janë pjesë e detyrave të tyre funksionale dhe këtë e kemi mbajtur në konsideratë dhe në rastet kur gjyqtarë të tjerë kanë kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë dhe kanë kërkuar që t'i konsiderohen botime. Kjo është pjesë e detyrës së ekspertit apo lehtësuesit. Për këtë arsye unë jam dakord me propozimet e relatores.

Ilir Rusi: Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Për të shtuar tek pjesa e publikimeve, ndër të tjera për të vlerësuar një publikim, ne do t'i referohemi edhe ligjit “Për arsimin e lartë”, çfarë është një publikim. Kështu që në këtë rast nuk është asnjë publikim, pasi publikimet mund t'i dërgohen një reviste por ato kalojnë nëpërmjet një procedure në rast se miratohen për publikim apo jo. Kështu që, fiks ka ngelur në tentativë.

Ilir Rusi: Po, zoti Toro!

Alban Toro: Po pra, ka ngelur në tentativë, sepse të drejtat i kaluan Shkollës për ta publikuar. Pra gjyqtari e ka konsumuar atë pjesën e vet. Nuk mund ta çoj ajo ta bëjë botimin. S'e çon dot ajo. Prandaj nënshkruhet kontrata, që të drejtat po të kalojnë ty. Tani edhe për këtë do fajësojmë gjyqtarin? Ajo e ka bërë pjesën e vet.

Irena Plaku: Domethënë, që të ketë publikim, duhet të jetë i publikuar.

Alban Toro: E kemi thënë që gjyqtari nuk është në rolin e prodhuesit të romaneve, të doktrinave, se ai prodhon vendime, dhe në rastin konkret për sa kohë kemi

një indicie që ky paska çuar për të publikuar një material të caktuar të ripunuar tek Shkolla... Tani në qoftë se do t'i japim kaq rëndësi kaq pjesës dhe nuk shohim vendimet?!

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime të tjera?

Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Për të mos rënë në përsëritje. I kthehem përsëri letrës së të drejtave. Duke mbajtur parasysh qëndrimet që kam mbajtur personalisht për sa i përket kësaj pike si dhe faktin e periudhës së punës kur gjyqtarja, bëhet fjalë për periudhën 2017–2019, si dhe faktin tjetër që meqenëse i është bërë e ditur çdo të pandehuri, nga aktet rezulton që është bërë e ditur, unë propozoj që për këtë pikë, për “Aftësinë e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore”, nga 8 pikë në 10 pikë. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Hallunaj!

Ka diskutime? Propozime të tjera?

Atëherë, për rastin konkret ka tre propozime të cilat do t'i përmendin një nga një dhe kalojmë tek votimi përkatës.

Atëherë nga ana e anëtarëve kërkohet që të votohet me propozimet duke iu referuar jo kronologjisë së propozimit të tyre, por duke iu referuar strukturës në lidhje me tabelën e vlerësimit.

Atëherë, në lidhje me propozimin e z. Hallunaj që ka të bëjë me rubrikën “Aftësitë organizative të gjyqtarës”, në rubrikën “Aftësitë e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore”, konkretisht “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, propozohet nga zoti Hallunaj që vlerësimi nga 8 pikë i propozuar nga relatorja, të jetë 10 pikë, duke i shtuar 2 pikë. Kalojmë në votimin përkatës.

Irena Plaku: Atëherë, kundër. Për sa i përket respektimit të të drejtave, gjyqtarja, siç u theksua më sipër, i ka respektuar dhe është vlerësuar për këtë tregues. Ky tregues lidhet me administrimin dhe dokumentacionin. Pasur parasysh dhe praktikën tashmë të mbajtur nga Këshilli në vlerësimin e shumë gjyqtarëve, të cilët për këtë tregues në rast të

mungesës së të drejtave është hequr 2 pikë, i qëndroj propozimit me 8 pikë.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Kundër. Është standard i mbajtur në të gjitha vlerësimet e tjera, kështu që qëndrimi im është kundër.

Alban Toro: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

(Nuk miratohet.)

Ilir Rusi: Kalojmë në propozimin e parë të bërë nga zoti Toro në lidhje me rubrikën “Aftësitë profesionale dhe angazhimi profesional”, konkretisht “Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, konkretisht “Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”. Referuar relatores ka një vlerësim prej 3 pikësh. Sipas zotit Toro, propozon për t’u vlerësuar në nivelin e 5 pikëve, pra duke shtuar 2 pikë.

Irena Plaku: Atëherë, i qëndroj propozimit tim, domethënë jam kundër këtij propozimi të parashtruar nga zoti Toro për shkak se kjo veprimtari e gjyqtares është vlerësuar tek treguesi tjetër, konkretisht në pjesëmarrja në programet e trajnimit vazhdues të gjyqtarëve dhe referuar rregullores për metodologjinë e pikëzimit, kjo veprimtari nuk klasifikohet si pjesëmarrje në veprimtari ndërinstitucionale.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

(Nuk miratohet.)

Ilir Rusi: Kalojmë tek propozimi i dytë i zotit Toro, në lidhje me rubrikën “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, konkretisht tek “Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, rubrika ç “Publikimet ligjore dhe akademike”. Do i kërkoja zotit Toro, çfarë niveli pikësh?

Alban Toro: Edhe për aty 2 pikë.

Ilir Rusi: Dy (2) pikë, dakord.

Faleminderit!

Për ta saktësuar domethënë.

Atëherë, ju lutem, nga përsëritja nuk na gjen gjë. Propozimi i dytë i zotit Toro që ka të bëjë me rubrikën “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, konkretisht tek “Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, saktësisht tek “Publikimet ligjore akademike”, nga ana e relatores është propozuar një vlerësim me 0 pikë, ndërsa nga zoti Toro me 2 pikë, pra duke u shtuar 2 pikë.

Vazhdojmë tek votimi përkatës.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

(Nuk miratohet.)

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të këtij vlerësimi të gjyqtares përkatëse, kalojmë në votimin e projekt-aktit përkatës në tërësinë e saj, me gjithë përmbajtjet përkatëse.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017-2019”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 02.11.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}, (relatore znj. Yllka Rupa).⁵

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:25 dhe mbaroi në orën 17:13.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

⁵ Sipas rendit kjo çështje renditet nr. 10. Pika 5 e rendit shtyhet. Shih procesverbalin e pikës së parë. 104

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor *znj. Fatmira Luli*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Dorina Prifti, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 5. Arben Lila, Përfaqësues nga EU4JUSTICE.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}, (relatore *znj. Yllka Rupa*).

Ilir Rusi: Në vijim, vazhdojmë me një pikë tjetër të rendit të ditës.

Atëherë për shkak të kohëzgjatjes së kësaj mbledhjeje dhe çështjeve që po trajtohen, nga ana e anëtareve kërkohet të bëhet një pushim i dytë.

Atëherë, anulohet kërkesa e anëtarëve, të vazhdohet me mbledhjen dhe konkretisht me pikën përkatëse të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtarit {...}, me relatore *znj. Rupa*. Për më tej fjalën relatores zonjës Rupa.

Yllka Rupa: Faleminderit!

Atëherë edhe në lidhje me projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të

gjqtarit {...}, ky projektraport ka për qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit, gradimin e gjyqtarit, i cili ka kaluar procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë.

Në projektraport paraqitet e plotë procedura e vlerësimit, gjithashtu edhe aktet e vlerësimit, burimet e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me të dhënat që kanë rezultuar prej tyre dhe që unë do të ndalem në analizimin e nivelit të vlerësimit dhe të pikëzimit lidhur me katër kriteret e vlerësimit për këtë gjyqtare.

“Aftësitë profesionale të gjyqtarit”. Aftësitë profesionale të gjyqtarit pikëzohen sipas dy treguesve: “Njohuritë ligjore” dhe “Arsyetimi ligjor”, të cilët ndahen në disa tregues. Kështu që, në lidhje me “Njohuritë ligjore”, “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në këtë drejtim, për arsye sepse identifikon qartë faktet e çështjes, natyrën e çështjes dhe normat konkrete procedurale dhe materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjeve konkrete. Propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 25.

Në lidhje me “Aftësitë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, referuar të dhënave rezulton se gjyqtari ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, ka identifikuar praktikën e Gjykatës Kushtetuese. Propozohet niveli i pikëzimit me 25.

Në lidhje me arsyetimin ligjor, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta, janë të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshme jo thjesht për njohësit e ligjit por edhe për një lexues të arsyeshëm. Propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

Në lidhje me “Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit”, evidentohet se gjyqtari në hartimin e vendimeve gjyqësore ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar, në përmbajtjen e së cilës gjyqtari i përmbahet si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtari ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit gjyqësor. Propozohet në lidhje me këtë nënkriter niveli i vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 10.

Për sa i takon “Cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik”, në shumicën e vendimeve gjyqësore të analizuara rezulton një nivel shumë i mirë i arsytimit, i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin penal objekt shqyrtimi, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale, si në rastet kur ai përbën shkak ankimi ashtu edhe në rastet kur analiza e fakteve dhe dispozitave me natyrë procedurale është thelbësore për zgjidhjen e çështjeve. Propozohet niveli i pikëzimit 25.

Në lidhje me kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtarit”, propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i takon “Aftësive organizative të gjyqtarit”, “Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë”, “Respektimi i afateve ligjore”, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet, për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari dhe 2 (dy) vendimeve të administruar për shkak të ankesave.

Nga vëzhgimi i tyre, rezulton se për asnjë prej tyre nuk parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes në apel, kështu që në lidhje me këtë komponent gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.

Për sa i takon “Plotësimin të standardit minimal kohor”, referuar çështjeve të përzgjedhura me short konstatohet se të gjitha kanë përfunduar brenda standardit minimal kështu që edhe në lidhje me këtë tregues propozohet niveli maksimal i vlerësimit me 5 pikë.

“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” – Edhe në lidhje me këtë nëntregues, rezulton që koha mesatare është më e shkurtër se standardi minimal për të gjitha kategoritë e çështjeve, kështu që propozohet niveli maksimal i pikëzimit edhe për këtë nëntregues.

“Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” – Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit rezulton i tejkaluar ky rendiment në 98% të këtij

standardi, kështu që propozohet niveli i pikëzimit me 5 pikë.

Për sa i takon “Kohës mesatare të arsytimit të vendimit përfundimtar”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar rezulton më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Propozohet niveli i pikëzimit me 15 pikë.

Në lidhje me “Aftësinë e gjyqtarit për të kryer procedura gjyqësore”, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, për këtë tregues, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 10 çështjeve me palë kundërshtare të për zgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2 seanca, dhe po kështu gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

“Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale. Propozohet niveli i pikëzimit 20.

Në lidhje me “Aftësinë e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore”, të dy komponentët e këtij nënkriteri “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” si dhe “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, vlerësohet kujdesi i gjyqtarit në lidhje me saktësinë, plotësinë, rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, kështu që propozohet niveli i vlerësimit përkatësisht 5 dhe 10 pikë.

Kështu që, në analizë të këtyre treguesve, niveli i vlerësimit për kriterin “Aftësitë organizative të gjyqtarit” propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", pikëzimi 100.

Në lidhje me “Etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale”, vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar për shkak të statusit, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion.

Në lidhje me etikën në punë, lidhur me këtë nënkriter propozohet niveli i

vlerësimit shumë i lartë, pikëzimi 35, pasi nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion, rezulton se për gjyqtarin në periudhën e vlerësimit nuk rezulton të jenë marrë masa disiplinore, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërbajtje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e tij. Për këto arsye propozohet niveli i vlerësimit shumë i lartë.

Në lidhje me integritetin e gjyqtarit, lidhur me këtë nënkriter, në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit, konkludohet se nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

“Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”, duke qenë se nga burimet e vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit, propozoj që ky tregues të vlerësohet në nivelin shumë të lartë, pikëzimi 40.

Për sa i takon përdorimit ose jo të gjuhës diskriminuese, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët. Gjithashtu edhe në lidhje me këtë nënkriter propozohet niveli i pikëzimit me 10.

Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, bazuar në aktet e vlerësimit rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarëve. Kështu që propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

Niveli i vlerësimit për këtë kriter propozohet të jetë "Shkëlqyeshëm", pikëzimi 100.

“Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, në lidhje me “Aftësinë e komunikimit”, “Komunikimi i qartë dhe transparent”, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në

arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Propozohet niveli i pikëzimit 25.

Në lidhje me “Respektimin e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale”, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të tyre, kështu që propozohet niveli i pikëzimit 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar”, në lidhje me këtë nënkriter gjyqtari shfaq shkallë të lartë komunikimi dhe bashkëpunimi, qoftë me kolegët duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta, qoftë me administratën gjyqësore, kështu që propozohet përkatësisht niveli i pikëzimit 15 dhe 10 pikë për të dy këto komponentë.

“Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, propozoj që gjyqtari duhet të pikëzohet me 20 pikë, pasi për periudhën 3-vjeçare rezulton pjesëmarrja e tij në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 7 ditë trajnimi, në katër aktivitete trajnuese. Kujtoj që legjislacioni i kohës, ndryshe nga përcaktimet që bën ligji “Për statusin”, përcakton vetëm kufirin maksimal dhe jo atë minimal.

“Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatë për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe për trajnimin e gjyqtarëve”, referuar të dhënave nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete të tilla, kështu që vlerësohet me 3 pikë.

Gjithashtu edhe në lidhje me angazhimin e tij në lidhje me veprimtari ndër-institucionale, propozohet niveli i vlerësimit me 3 pikë, pasi nuk rezulton të ketë dhënë kontribute të tilla.

Ndërsa për i përket “Publikimeve ligjore akademike” gjyqtari nuk vlerësohet për arsye se nuk provon të ketë të tilla.

Kështu që në lidhje me nivelin e vlerësimit dhe të pikëzimit për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional” për këtë gjyqtar, propozohet niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”, pikët 91.

Në mënyrë të përmbledhur, propozimi për nivelin e përgjithshëm për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë organizative të gjyqtarit, pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, pikët 100, niveli i vlerësimit

"Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, pikët 91, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Pra vlerësimi i përgjithshëm në lidhje me këtë gjyqtar është "Shkëlqyeshëm", pikët 391.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Rupa.

Zoti {...} është njohur me këtë projektvendim. Gjithashtu nuk ka paraqitur kundërshtime. Ftoj anëtarët nëse kanë diskutime apo jo.

(Nuk ka diskutime.)

Ilir Rusi: Meqenëse nuk ka diskutime, atëherë kaloj në votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim "Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes, për shkak edhe të karakterit të çështjeve, mbledhja do vazhdojë me dyer të mbyllura.

(Ndërkohë, nga ana e anëtarëve bëhen disa minuta pushim, për të vijuar më pas me çështjet e mbetura nga rendi i ditës, për të rifilluar mbledhja në orën 16:13.)

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor